

8JH-32

289

ÇERÇİZ  
LOLOÇI



*Tregime*

8JH-32

489

---

ÇERÇIZ  
LOLOÇI

---

TREGIME



---

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

---

## Këngë e re

1

Duhej të kisha shumë kohë që rrija i mbështetur mbi parvazin e dritares duke shikuar jashtë. Trëndafili, në të cilin ishin ulur disa zogj, fiku i laruar dhe gardhi i përçafuar me kulpër, pra e gjithë pamja e kopshtit herë më afrohej duke m'u qartësuar deri në inde, herë më largohej duke u bërë njësh me sfondin e maleve të pudrosura me re të përhimë. Qëndroja si i ngrirë dhe dëgjoja me ëndje fëshfërimën e erës që sapo nisi. Krahët e disa zogjve të murrmë u hapën dhe mua m'u duk sikur lundruan në erë tërë gaz. Macja, e mbledhur shuk në rrëzë të fikut shëngjinas, shpeshherë matej të kapte ndonjë zog nga ata që fluturonin ultas, duke ndjekur njëri-tjetrin. Ky është një çast i zakonshëm në fshat, por, kur je larguar për një kohë të gjatë prej tij, ndien mall qoftë edhe për këtë. Bile, në raste të tilla mund të harrohesh në

vetvete; i pushtuar nga malli, s'shikon e s'dëgjon asgjë, veç ndien përbrenda të të vërshojnë tinguj e zëra.

Ashtu edhe unë përmendesha dhe bija prapë në mendime. Këtë vit nuk erdha dot në fshat për pushimet e janarit, se u sëmura nga verdhëza. Gjatë kësaj kohe që kisha munguar, e ndieja dhe e shikoja që kishte lëvizur diçka. E, mbi të gjitha, më tepër diskutohej për ujin dhe tufëzimin. Lajmin për ardhjen e ujit në fshat e mora vesh në shkollë, kur po jepja provimin e maturës. «Erdhi uji, tri shtëpi një cezmë», më shkruante vëllai në telegram dhe shokët e mi qeshën. Telegrami i vëllait atje në shkollë më solli ndër mend historinë e banjolavanderisë që, megjithëse u hap, asnjë nga fshatarët nuk shkante të lahej. Laheshim vetëm ne nxënësit e shkollave. U la edhe kryetari i Frontit, por, për çudi, u ftoh dhe e zuri rrufa. Fshatarët që e shihnin me shami në hundë, qeshnin. Edhe nëna ime qeshte kur tregonte për të. Por mbrëmë, sa erdha në shtëpi, ajo më tha: shko lahu në banjë se të qetëson. Pse bën shaka? Lahu, lahu, se kemi skal-dabanjën në musandër... C'ti thoshe nënës. Ajo s'të linte radhë të flisje. Kanë shumë në fshat të tilla, përsëriste ajo.

Pas pak një krah i giatë si degë dardhe u shqua tej, në rrëzë të gardhit. Dora lëvizte poshtë e lart në shenjë përshëndetjeje.

— U mblodhe në limer, — foli një zë i trashë.

Unë u përmenda dhe njohta Rahimin. U përqaftuam si miq. Rahimin kurdoherë e sillja ndër mend me atë trupin e fortë e me krahë të fudishëm. Sa herë që ngriheshin shtëpi të reja, ai do ta gjente kohën që jo vetëm «të punonte si ka, por edhe të hante si ka».

— E bëtë tufëzimin? — e pyeta.

— E bëmë.

— Si u prit?

— Pyet nënën tënde.

— Si?

— Po ja, e mira s'duket tani. Në stane kanë prurë edhe të rinj shtatëmbëdhjetë-njëzetvjeçarë.

— Pse, ti s'ke qenë shtatëmbëdhjetë vjeç kur shkove?

— Aq kam qenë, po sivjet prunë shumë të rinj.

— Po me Seferin, Faten, Boron, si bëtë?

— Janë pleq e s'u vjen mirë. Seferi thotë: iku dhia, erdhi dhria, domethënë kohën që merrej me bagëtinë, do të merret me pemët e kop-shtit, se ujët që erdhi në fshat tërboi dhenë. Kurse Borua, mesele më vete: hem jam dakord, hem s'jam. Fliste në mbledhje e sytë i përloreshin. Tani ka vajtur në një tufë ku janë edhe bagëtitë e tij. Me shtetin jam në rregull: «dorëzova bagëtitë, po edhe me veten jam i lehtësuar, plaçkën time e shikoj çdo ditë», thotë.

Rahimi më shpjegoi edhe pak për ato që diskutoheshin në fshat pas tufëzimit dhe u nis në stan. Unë u shtriva në shtrat pa menduar për gjë. Për dy ditë në trurin tim qenë derdhur gjithë informacionet gojore të fshatit: dasmat, lindjet, ndonjë vdekje, vajza e Demos që do të vazhdonte studimet në Bordo; ishin grindur në bostane Zylfua me Shyton, uji, tufëzimi. Kam kohë të mësoj ende hollësisht. Ndërkaq solla ndër mend Rahimin, mikun tim...

Kam qenë i vogël atëherë. Në shkollë s'kisha hyrë ende, prandaj nuk lija vend pa shëtitur. Kudo shkoja me manaren time, që i thërrisja Cume. Atë e rritnim me copa buke. Shpesh copat e bukës më thaheshin në xhep, ndaj i njomja me ujë dhe ia shkërmoqja me gojë. Cumja vinte e

mbushur nga trupi dhe mua më dukej çudi që rritej aq shpejt, si kungulli, ndërsa unë isha i hollë, si spango.

Rahimi nuk kishte shkuar ende ushtar. Kishte mbaruar shtatëvjeçaren dhe punonte në bujqësi. Unë e doja shumë atë dhe kjo ngaqë nuk kisha vëlla të rritur dhe se shkonim mirë si familje. Ai që mbrojtësi im, kur unë bashkë me Cumen vizitonim ndonjë bostan.

Menjëherë, sa u kthye nga ushtria, Rahimi u fejuar. Ai kishte ndryshuar shumë. Fytyra e tij e butë, e rrumbullakët, tashmë dukej e hequr: pushi i bardhë që zëvendësuar nga qimet e zeza e të ashpra.

E fejuara quhej Milka. Kur takoheshin të dy, skuqeshin...

Atë ditë ishte gjashtë mars dhe në fshat u ndezën dritat. Të gjithë gëzoheshin. Një grup fshatarësh kishin zbritur poshtë fshatit, mbi një breg, dhe shihnin fshatin me drita. Ndoshta fshatarë që shihnin të përmalluar poshtë kishte edhe mbi fshat. E megjithatë nga çdo kënd që ta kundroje fshatin atë mbrëmje, dukej i bukur.

Bleva bukë në dyqan dhe u nisa për në shtëpi. Rrugët ndriçonin dhe, ngaqë shihja lart, u rrëzova nja dy herë. Te bregu i sipërm arrita Milkën. Ajo ecte ngadalë, kryeulur dhe drita i ndriçonte hundën e vogël dhe një pjesë të ballit. Më shkrepri në mendje se ajo dikë priste, prandaj i kalova përpara dhe u fsheha rrëzë gardhit të Rahimit. Aty u ula mbi një gur. Pas pak erdhi Rahimi. Ata diç folën. Rahimi zgjati duart drejt fytyrës së saj. Shikoja pa marrë frymë dhe zemra më rrihte me hov. Ata të dy, me fytyra të afëruara, shikonin atë si polen të verdhë që lëshonte llamba elektrike. Gëzojnë për dritat, tha-

shë me vete. Lehu një qen. U sula me vrap. Pas meje vinin hapat e nxituar të Milkës.

Dhoma sikur u errësua. Fshiva sytë. Po dremitja. Dielli që futur midis reve të dendura. Megjithëqë po perëndonte, bënte vapë.

2

Qeni lehu fort dhe unë për një çast shtanga. Jo larg ngriti krifën e zezë një qen leshtor e trupmadh. Vështrova përreth dhe nuk po gjeja asnjë gur për ta qëlluar. Do qëndroj në vend, mendova. Po ja më hëngri, pastaj ha tetanozin në bark!

Poshtë ishte një gropë e madhe, hapur qysh nga lufta. Në sipërfaqe të gropës kishte bar të njomë. Aty po kulloste qetë-qetë një kalë i bardhë. Nuk u mendova gjatë, po zbrita në gropë, nëpërmjet një rrugice, dhe iu hodha sipër kalit pa samar. Kali turfulloi dhe ngriti kryet lart. Mbase u çudit nga mysafiri që mbante mbi vete. Pastaj, kur pa qenin duke angullirë, nuhati diçka dhe uli kryet pa e prishur terezinë.

Po afronte mbrëmja. Dëgjoheshin zilet e dhive që, me sa ma merrte mendja, kullotnin në faqen e përtejme të malit. Po tani, ç'të bëj? Është edhe turp të më gjejë njeri hipur mbi kalë se trembem nga qeni... Po mendoja i përkulur mbi jelet e kalit, kur dëgjova një zë që e përsëritën malet :

— Manoz!

Ngrita kryet lart, po s'dallova asgjë. Nga lindja malet përkarshi kishin dritë dhe nën dritë ishin ulur hijet e maleve të perëndimit. Qeni shfryu tërë mllef duke nxjerrë dhëmbët dhe u largua i zemëruar. Zbrita nga kali dhe e fërkova

në ballë. Dola sipër gropës ende me një ndjenjë frike. U afrova te kasollja pak më tej, ndërtuar rrishtas, që mbante përsipër gjethe, plastmasë dhe disa rroba. Toka rreth saj që disi e ngritur dhe e mbuluar me bar e rrallë me sfaka dhe kasollja më ngjau sikur të kishte hipur mbi vithet e një kali të shëndoshë.

Nisi të frynte erë dhe unë nuhatja me kënaqësi aromë pylli. Kumbimi i zileve po afrohej. Në rrëzë të malit u shfaqën dhitë e para, të cilat u sulën me të shpejtë drejt disa gurëve të bardhë, shpërndarë aty-këtu nëpër luadh. Ato lëpinin kripën duke shtyrë njëra-tjetrën. Tutje pashë dy barinj të dhe prapa tyre vinte qeni i zi, leshtor. Njoha Rahimin. Tjetri ishte nja tetëmbëdhjetë vjeç, me flokët e zinj të lakuar që ia mbanin fytyrën si në kornizë. Ai ishte Brahoja.

— Do na ngasësh pak dhitë, se nuk na ka ardhur lloja, — më tha Rahimi, — merr edhe radion dhe hape.

Mora radion «Adriatik» dhe, sa lëvizta çelësin, në luadh vërshuan tingujt. Po bëheshin katër vjet që s'kisha shkuar në stane dhe përfytyrimi im për to ishte vetëm disa kasolle si të zbardhura, ku vazhdimisht dilte tym. Edhe këtu ka ndryshuar diçka, fola me vete. Radioja është ngjitur kasolle më kasolle me atë gëzim që ngjitet vite më parë nëpër fshatra... Pastaj mendova për Rahimin. Më vinte çudi si fliste ashtu. Ja edhe Brahoja, një vit më i vogël nga unë, më dukej i burrëruar dhe në fytyrë i lexoja sigurinë.

Dhitë, si i molën, u shpërndanë nëpër luadh. Radioja jepte lajmet.

Ne hëngrëm bukë dhe u futëm në terrin e kasolles. Rahimi seç lëvizi dhe çdo gjë brenda u ndriçua nga llamba me bateri. Kasollja ishte e pastër sikur të kishte vënë dorë një nikoqire e



mirë. Në kulm u dukën dy fenerë të nxirë vende-vende. Majtas, në faqen anësore të kasolles, ishte rafti me disa libra, letra të bardha dhe një laps. Djathtas ndodhej një tjetër raft, ku qenë sistemuar rrobat e fjetjes. Poshtë tij ishte një valixhe e vogël prej druri.

Në majë të malit nxori syrin hëna dhe drejt kasolles po vinte Iloja. Ai u përshëndet me shokët dhe mua më përqafoi. Në fytyrë kishte një purpur të lehtë gëzimi.

— Na vjen bashkë me hënën, — tha Rahimi.

— E po duhemi, ndaj rrimë bashkë. Hënë ka bërë edhe natën, që u martova, — tha Iloja dhe u ul afër derës së kasolles. Drita e hënës nxirrte në pah trupin e tij të mbledhur e të paktë, shapkën pa strehë, si këpurdhë, dhe fytyrën paksa të rruddhur.

— E more samarin? — pyeti Brahoja.

— Hë, e mora, po gjeta belanë...

Ne e shikuam në sy dhe ai vazhdoi:

— Marr samarin dhe zbres poshtë, tek Ura e Madhe. Ulem në shesh, bëj një duhan dhe shikoj samarin që ma kishin bërë për merak. Mbarova duhanin e dola në mes të xhadesë. Tëhu vinte një makinë. Ngrita dorën lart, por ajo nuk ndaloi. Kaluan edhe makina të tjera, por edhe ato s'më morën. Mbase s'i saidiste samari. U telekosa, më mbeti dora lart. Pastaj vjen një taksisi që frenoi mu përpara këmbëve të mia. «Të më vic për darkë», më thirri një zë. Njoha kolegun tonë. Vadiun. Ai e ka stanin te Gropë e së Bërës. Gëzonte i shkuluri Vadi, kishte marrë televizor «Butrinti»! «Një vit nuk i mora lekët e pensionit, i mbledha dhe e bleva», më tha dhe më hodhi duart në qafë. Më uli kokën poshtë dhe më vendosi shishen te buza. «Mos më uro, të vic në shtëpi, merr dhe njerëzinë e dilni», tha prapë

ai. Mirë, more, mirë, po nëm pak këtë kutinë se mbeti televizori tjetër këtu, i them dhe i tregoj samarin. Qeshi dhe ma dha. Qëndrova një gjysmë ore, derisa erdhi «fizarmonika». Kutinë e futa brenda me një djalë sa Brahoja. Ai e mësoi që brenda në kuti ishte samari, qeshi një copë herë dhe pastaj e qepi gojën. U rehatova në karriqe dhe vura dorën sipër kutisë. Njerëzit që kisha afër, më uronin dhe mbaheshin fort që të mos e preknin. Vjen fatorinoja. «Ç'markë e ke?» më thotë. U zura ngushtë, po më vinte edhe për të qeshur. Nga tonat është, i them. «Ja, lexoje», thotë ai djali, sa Brahoja, që më ndihmoi dhe buzëqeshi pakëz... Zbrita nga «fizarmonika» dhe e prura samarin në shtëpi.

— Do vij në njerëz të të urojnë, — tha duke qeshur Brahoja.

— Le të urdhërojnë. Do ta marr dhe unë televizorin se gëzojnë në shtëpi.

Dolëm jashtë. Brahoja shtroi rrobat dhe u fut përsëri në kasolle. Nisën të lehnin qentë. Në horizont u rrëzua një yll. Iloja mbylli sytë. Qysh sa u futa në kasolle e deri në këtë çast që po bisedoja me Rahimin, më shqetësonte diçka: aty poshtë raftit të rrobave ishte një valixhe e vogël prej druri. Përse e donin atë valixhe? Kujt i hyn-te në punë? Atje që përkulur tashmë Brahoja.

U ngrita mbi bërryla dhe shikova më mirë drejt hyrjes së kasolles.

— Ç'shikon? — pyeti Rahimi.

— Brahon dhe...

— Ti nuk e di, por ai është kandidat partie...

Rahimi vazhdonte të tregonte për Brahon, por unë gati nuk e dëgjoja më. U madhova i tëri, u përtëriva. Një ndjenjë e ngrohtë më shpërtheu në trup. Brahoja tetëmbëdhjetëvjeçar kandidat partie...

Ecën Brahoja, ecën. Para syve të mi u shfaqën monopetet. Shtegton kopeja, shtegton mushka e ngarkuar me rroba, shtegton edhe valixhja me veprat e Enver Hoxhës... Valixhen ai e mban para duarve dhe e shtrëngon fort.

— Ky është Brahoja, — përfundoi Rahimi.

Braho, murmurita unë me dashuri. Braho, vazhdonte të më thërriste diçka përbrenda si për një send të dashur, të afërt, të brendshëm. Këtu pranë meje qenë shtrirë Rahimi e Iloja. Aty, në cep të kasolles, lexonte kandidati i Partisë. Duhet, patjetër që duhej një këngë e re për çobanët...

## *Reti s'bëri më shaka*

Mesditë shtatori. Bregu i Jonit zhurmon nga studentët, shpërndarë grupe-grupe. Sapo kemi lënë punën dhe ende s'kemi filluar të lahemi. Kështu çdo ditë: mbarojmë normën, lahemi për pak kohë dhe nisemi për në fjetina. Të dielave vemi në det më shpejt dhe aty nga pasdrekja kthehemi. Koha bën e mirë, ditën dielli djeg, kurse mbrëmjet e netët janë të këndshme e të freskëta nga kollitja e detit dhe frymëmarrja e plantacioneve të gjelbëruara e pa mbarim.

Në krahun e majtë timin është Iliri, që shikon përhumbshëm mbi det. Në anën tjetër janë Leta dhe Reti. Të katër jemi tetëmbëdhjetëvjeçarë, të katër kemi qenë shokë në shkollë të mesme dhe ja, në muajin e parë, studentë. Unë quhem Elona dhe kam qejf të notoj larg, po mbrëmë komandanti i aksionit na e ndaloi me urdhër dite. Sot do të merrja me vete edhe Ilirin. Pse sot? Unë gjithmonë, këto ditë aksioni.

me atë notoj, notojmë krah për krah, lehtas, duke folur për subjekte filmash apo librash. Iliri noton mirë, po trembet të shkojë larg. I vjen keq për mua, për Letën, për Retin; mendon sikur nga çasti në çast mund të na përpijë dëti. Ose jo, ai nuk trembet, po më tepër është i kujdesshëm. Tashmë ka zhytur këmbët në ujë dhe në kreshtën e gjunjëve i formohet një vijë lakuese nga përplasja e valëve. Ndien të ftohtë, dridhet në trup dhe pushi i bardhë në këmbë i çohet lart.

— Eja të fillojmë të parët, — i çuquris te veshi dhe e kap nga dora.

— Vetëm ne?

— Ec, se më vonë do të ketë dallgë.

— Nuk do të ikim larg.

Unë i tund kryet dhe lëshohemi të dy në det. Valët e lehta na përpiqen prapa krahëve. Disa metra larg nesh notojnë Leta dhe Reti. Ato diçka thonë për mua e Ilirin dhe kukurisin fort. Me siguri thonë ato që kanë lexuar në bllokun e tij. Iliri shkruan përshtypje, mbresa, kujtime dhe na i jep t'i lexojmë. Ai ka shkruar edhe disa raddhë për mua, që s'na i dha t'i lexonim, megjithëse Reti dhe Leta i morën vesh. «Më duket se të do, por druhet të ta thotë», tha Reti. «Ne jemi shokë, dashuria s'është...», belbëzoi Leta për të zbutur zemërimin tim. U largova prej tyre pa u thënë asnjë fjalë. Ato të dyja rendën drejt meje dhe më thanë ta harroja bisedën që bëmë. Është lehtë të thuash harroje! Harroje bisedën, por Ilirin ne e kemi shok, jemi mësuar me të, tha Reti...

Ndoshta Leta dhe Reti flasin për aksionin. Dy herë u gatitëm në shkollë të mesme, po nuk shkuam. Ky është aksioni ynë i parë. Kur u nisëm nga Tirana, ra një shi i madh. Studentët rrinin

brenda në autobus, kursë jashtë, të mbledhur nën çadra, disa prindër. Qe një skenë tamam për të qeshur: ata flisnin e flisnin pareshtur dhe nuk ndienin brufullimin e pikave të mëdha që shkundeshin nga era mbi supet e tyre. Për të qeshur?! Ç'them unë? Atje qe edhe nëna ime. Ajo fliste duke lëvizur buzët dhe unë dëgjoja nëpër të fraza të shkëputura, pasi në përfytyrimin tim ishte sajuar sakaq një nga ato udhëtimet që zgjatin e zgjatin e që ruajnë të papritura befasuese. Disa nga ne për herë të parë largoheshin nga shtëpia dhe ata që rrinin përjashta e lageshin në shi, kishin merak.

Ditën e parë në Lukovë qemë të emocionuar. Qytezën e pamë shumë pak; ajo qe mbuluar nga mjegulla, errësira, madje edhe dritat ngjanin si pishtarë, varur në degë pemësh. Atë natë nuk fjetëm fare. Një vajzë e vitit të dytë frëngjisht dilte në krye të kapanonit dhe tregonte anekdota. Herë-herë kalonte shtrat më shtrat dhe, me atë të qeshurën në cepat e buzëve, më kapte nga faqet e bënte portretizime të shpejta. «Mos u rrotullo natën se do të prishësh sustën e krevatit», i tha ajo një imcakeje nga Elbasani. Ose Retit: «Sy të blertë në këtë mjedis të blertë, ki kujdes nga simpatikët e Lukovës.» Çudi me atë vajzë! Çudi edhe me ditët që rendin pakuptuar. Ditën e dytë s'patëm më mundësi ta gdhinim, se na zuri gjumi si pulat. Edhe ditën e tretë, të katërtën. Pak nga pak po na shkrihej droja. Reti nuk ankohet më për filluskat e duarve. Unë e kam dëgjuar një natë duke qarë, qante ashtu përmbys, me një dënësë të mbytur, që i shkundte gjithë kurmin. Reti është vajzë e vetme...

U bënë dhjetë ditë që jam larguar nga Tirana dhe malli për njerëzit e shtëpisë më ka marrë sa s'thuhet. Dy herë kam folur në telefon me

mamin dhe ajo është përлотур. «Shko tako kushëririn. Hë pra, atë zeshkanin me dy nishane në fytyrë, që na solli peshk për Vitin e Ri... Prit, moj shoqja centraliste! Ke fëmijë ti? Ashtu... Reti, Leta, Iliri mirë janë. Si nuk të rregulluam një raport...» Mami jep porosi pa mbarim. Centralisti tjetër i Lukovës buzëqesh lehtë. Unë skuqem, e falënderoj atë dhe dal jashtë.

Leta dhe Reti janë afruar dhe na spërkatin me ujë.

— Kthehuni, kaluat vijën e verdhë të komandantit, — thotë Leta.

— Ruajuni nga dallgët e brendshme, — buzëqesh Reti. Ato kukurisin përsëri dhe kalojnë para.

Iliri buzëqesh pa i çelur buzët. Duket i heshur. Ka disa ditë që edhe mua më vjen zor të flas lirshëm para tij. Dhe kjo qysh nga çasti që Iliri shkroi ato vargje për mua. Çfarë ka shkruar? Njëfarë dashurie a dhembshurie, pa kufij të qartë, pak a shumë diçka e tillë, që më tepër ndihet sesa thuhet. Apo ku ta dish?

Ku ta dish shqetësimin tim mbrëmjeve të aksionit? Sa bie të fle, veshët më zhurmojnë tinguj, zëra, mërmëritje, lëvizje, sikur një dorë befash më shkund prej supesh dhe unë zgjohem e trembur. Asgjë. Në fjetinë qetësi. Njëzet e nëntë vaiza dihasin në gjumë dhe ajri rreth meje fërgëllon. Dëgjoen mërmërima fjalësh dhe ndonjë përplasje buzësh. Ja, tani po çohet një vajzë që e njoh vetëm si fytyrë. Ashtu përgjumësh ajo i afrohet derës e zgjat dorën drejt çelësit të dritës. Unë i shikoj vetëm shpinën, por ajo patje-

tër qesh me vete. Drita e hënës mbush tërë fjetinën. Vajza fërkon sytë me kurrizin e dorës, shkon me çap të lehtë te shtrati i saj, shtrihet dhe qëndron syhapur. Ndoshta mendon si u gënjye këtë mesnatë nga drita e hënës. Sa e mirë kjo gocë! Nuk është postëkapanon, lodhet në punë e megjithatë çdo mbrëmje do të bjerë e fundit. Si nënë e dhembshur, ngrihet nga shtrati ashtu si tani dhe shuan dritën e harruar ndezur. Dhe duhet të ndiejë diçka të ngrohtë në trup, diçka njerëzore. S'më marrka gjumi. Më del përpara drejtori i fermës, me atë trupin e paktë që, siç thotë brigadieri ynë, «të dyja herët veproji si komunist». Herën e parë drejtori ishte i sëmurë nga grykët. Rrinte lënë shtëpi shtrirë, i mbërthyer nga diersët. Pikërisht atëherë nga deti erdhi cikloni. Drejtori që çuar nga shtrati dhe bashkë me një agronom, që banonte afër tij, u kishte rënë kryq e tërthor agrumeve për të parë dëmtimet e bëra. Pas kësaj i kishte lënë porosi agronomit dhe ishte shtrirë përsëri në shtrat. Herën e dytë kishte qenë mbledhja e ndërmarrjes për vjeljen e agrumeve. Mbledhja dihet, që e rëndësishme; ndërkohë drejtorin e lajmërojnë se i kanë shtruar djalin urgjent në spital. «Shokë, kishte thënë, «mbledhjen e shtyjme për nesër, dialin e kam rëndë...» Plot ndjenja më buisnin në shpirt. (Dallgë të brendshme, i thashë një ditë Retit dhe ajo ma përsëriti me shaka.) Ato janë shumë, më ngazëllejnë dhe ma largojnë gjumin. Sonte edhe filxhanët në shtyllat elektrike më ngjajnë si zogi të vegjël kllocke. A mund të fle? E si... Po të fle, gjithëcka e bukur, e mirë, do të fashitet në kujtesën time...



— Kush thërret? — foli befaz Iliri.

— Ë, — e shikoj e hutuar, — askush.

— Vërtet s'më thirri njeri.

Hedh sytë përreth, po s'dalloj asnjë frymë njeriu. Të gjithë studentët janë ulur në breg. Edhe Leta me Retin kanë dalë nga deti.

— S'dëgjova gjë, — i them.

— S'më besohet, — ai zhyt kryet në ujë. — Tani nuk dëgjohet gjë, po qëparë dikush më thirri në emër.

— Do të kenë folur floçkat e detit.


— M'i mbyll veshët, se do të zhytem përsëri, — buzëqesh ai.

\* \* \*

Pragmbrëmje. Sa e re kjo qytezë. Dekorin e saj e plotëson fshati. Ai duket i vogël, i kërrusur para qytezës, veç ka një rrugë me kalldrëm që të mahnit. Kjo udhë, si dritare shtëpie me kanate përherë të hapura, zbret në det duke hyrë në intimitet me të. Diku në mes të kësaj rruge na ka ndalur një grua e moshuar, me flokë të bardhë të gjatë e pa shami në kokë. «Pritni, jeto! Merrini këto», na tha dhe na zgjati arra edhe ftonj. «Eni prapë këtu, se unë do të rroj gjithë jetën.»

Edhe ditët e fundit të aksionit vishen me mall. Një mall tjetër ky, tjetër nga ai i shtëpisë. Ne të katër e kemi bërë zakon të shëtitim sa më tepër këtyre mbrëmjeve të fundit. Si ne janë edhe studentë të tjerë. Udhët e qytezës grumbullojnë dialogë.

— Pushoni, — thotë Reti dhe na del përpara. Dëgjohet llokocitja e ujit të burimit përkaj fjetinave e disa zëra:



— Ti je oficer?

— Po.

— Sa vjeç?

— Tridhjetë.

— Sa mirë do të ishte të martoheshe.

Dëgjohet zhurma e ujit dhe e duarve që përplasen mbi rroba.

— Martohu, që të mos lash rroba.

— Jam fejuar.

— Kur të martohesh, më ço lajm se do të vij.

— Patjetër.

— Au revoir mon ami!

— Au revoir.

Zërat fashiten dhe ne vazhdojmë të ecim. Pa folur. Shikoj të tre shokët e mi. Ata duken të menduar. Për çudi, Reti s'bëri më shaka me dallgët e brendshme.

## «Tronditja»

Dikush i tha se dukej më i ri dhe Binerit i erdhi me të vërtetë mirë, sepse kishte mbushur plot gjashtëdhjetë vjeç. Këtë mëngjes që ngritur herët dhe erdhi këtu, buzë lumit, ku do të bëhej festa: do të përkujtohej krijimi i batalionit partizan të zonës. Kishte disa vjet që ai çohet herët për në festë, të cilën e priste me gëzim si fëmijët. Aty takohej me të njohurit, i pyeste dhe e pyesnin për shëndetin dhe në kulmin e hareshë dilnin edhe në fotografi.

Tani dielli kishte rënë dhe sheshi buzë lumit, i kredhur nën hijen e rrapeve, u mbush me njerëz. Diku këndohej, diku hidhej valle e të gjithë lëviznin të gëzuar. Bineri kalonte sa në një vend në tjetrin duke ndier përbrenda ngrohtësi; rrobat e leshta i dukeshin të lehta, fare të lehta. Gjithë genia e tij ecte dhe fliste.

Pas ca, muzika pushon dhe zërat nemiten. Fillon mitingu. Atë e përshëndet një e deleguar e Komitetit Qendror.

Sytë e Binerit kthehen nga shpina e një burri të gjatë, rreth të pesëdhjetave, që i dallohet qafa pakëz e kuqe, e zhubrosur dhe kostumi i zi, si i zbardhur e i gërryer, me vija vertikale të holla. Ai është Çausi, nga fshati i tij. Binerin në këtë çast diçka e shtrëngon në grykë, ndien të dridhura në trup dhe sytë i mjegullohen. Qëndron për disa sekonda si i trullosur nga një ngjarje që i ka mbetur thellë në mend. Pastaj mendimet i kthjellohen dhe para syve i shfaqet silueta e Çausit, me thesin në krah, që zbret rrugës së qytetit...

Në Nelis erdhi fjala se do të hapej një kurs njëvjeçar për infermierë. Ky lajm ngjalli kureshtje dhe nisi kështu interesimi. Vetëm kur u mësua se në kurs do të shkonin ata nxënës që kishin mbaruar shkollën e mesme, disa u tërhoqën. Pra interesoheshin ata prindër që i kishin fëmijët me shkollë të mesme. Më tepër nga të gjithë shqetësohej Çausi. Ai kishte një vajzë që sapo i kishte mbaruar shkollën e mesme. Vajza e tij çalonte nga njëra këmbë, prandaj edhe ai s'gjente qetësi.

Një ditë shkoi në qytet. Atje u takua me një kushëririn e tij.

— Ç'të, mundon? — e pyeti ai Çausin kur e pa fytyrëprerë.

— Lërmë. Vajzën e kam sakate. Është hapur një kurs për infermiere dhe dua ta regjistroj.

— Ohu, po këtë punë e bën shoku Nebi në komitet.

— E kanë në dorë ata të fshatit.

— Urdhëron shoku Nebi.

— Ashtu?! Ahere po shkoj që tani, — thirri Çaushi.

— Aaa, jo kështu. Shoku Nebi vërtet rregullon punë, po do dashin me vulë të bardhë.

— Ama, qerrata burrë! — psherëtiu Çaushi.

— Dashin me vulë, dëgjove?

— Në fshat thuhet se në kurs do dërgojnë nuse e jo vajza, se vajzat kushedi ku martohen.

— Shoku Nebi, po pa dashin, të rregullon edhe plakën.

Çaushi u nda nga kushëriri dhe mori rrugën për në shtëpi. Në mendje i vinin vërdallë fjalët që i tha ai. «Shokut Nebi ti do t'i sjellësh diçka që t'ia ngopësh syrin. Veç jo t'ia shpiësh në zyrë! Papapa, në asnjë mënyrë! E shikon atë shitësin që ngjan si mumje? Hë, ja tek ai do të shkosh. Për shokun Nebi do t'i thuash dhe dera e zyrës së Nebiut është e hapur, bursa sigurohet.»

Fjalët e kushëririt ai i kujtonte përherë në shtëpi dhe nuk gjente dot prehje. Netve rrinte pa gjumë pinte shumë duhan. Edhe kafen, përveç në mëngjes, e pinte edhe në mbrëmje. Buka sikur s'i kapërdihej, kalonte vetëm dy-tri kafshata dhe pastaj e linte në mes. Herë-herë në mesnatë ngrihej ngadalë nga shtrati, dëgjonte dihatjet e vajzës në gjumë (atij i dukej sikur ajo rënkonte) dhe binte thellë në mendime.

Shoku Nebi kërkon dash me vulë? Kërkon mish?... Thua t'i ketë të vërteta këto fjalë kushëriri im? Po unë ku ta gjej mishin? Bagëtitë i kam tufëzuar. Tufëzova gjashtë dhi e katër dhen. Kurse dashin, Cikon, ma bleu kooperativa. Edhe ai është në tufën e kolektivizuar. Më dhembti kur i tufëzova. Po nuk isha vetëm unë. Të gjithë në fshat, në kooperativë i tufëzuan. Dhe të gjithë më mirë jemi. I morën deshtë e tjerë e i shpunë në grumbullim. Dashin tim e mbajtën, se ishte më i

miri. Kurse ky Nebiu nuk pyetka. Në do zana-  
nat për vajzën, gjej dash, gjej... Hej drejt o pu-  
në!..

Hamendjet e Çaushtit nuk mbaronin. Pasi e  
mundoi trurin për disa ditë, vendosi të therte Ci-  
kon, dashin e tij. Këtë e bënte për vajzën, për  
atë që u rrit sakate. Për atë vajzë atij i pikonte  
në shpirt. Thellë në shpirt!..

Atë ditë Çaushti u ngrit herët. Kopeja e dhen-  
ve kulloste. Se dhentë, ditën, kur shtrëngon vapa  
e korrikut, rrinë hijeve dhe në freskinë e na-  
tës kullotin.

Iu afrua kopësë dhe shikoi përreth. Nata e  
ngarkuar me yje sikur mërmëriste me gjuhën e  
saj të belbët. Heshtjen e thyenin vetëm këmborët  
e dhenve.

Çaushti u mbështet rrëzë një lofate dhe përgjoi  
zhurmat. Qentë s'ndiheshin. Kushedi nga bredhin,  
mendoi. Por edhe të jenë, ato s'të hanë. Edhe pla-  
ku Boro s'dëgjohet. Mbase e ka zënë gjumi. Ai ka  
kënduar gjithë natën dhe afër sabahut ka bash-  
kuar kapakët e syve. Këndon Borua. Dy djem  
i ka oficerë, i treti i mbaron të lartën për zoo-  
teknik. Vetë në pension, gruan në pension, merr  
edhe dyzet ditë pune si çoban. Pse të mos kën-  
dojë? Edhe unë mirë jam; djemtë i kam në pu-  
në, dy vajza i kam martuar. Po dua ta rregulloj  
edhe këtë vajzë, se... Ajo s'e ngul fare një  
këmbë. Më beso, e ngul vetëm pak. Pak, shumë  
pak... Ah?!.. Tetëmbëdhjetë vjet me shpirt hava-  
dan. Edhe gruaja ime...

Ai shkundi mendimet dhe iu afrua kopësë.  
Dhentë u stepën dhe u ngjeshën midis tyre. Në  
krye të tyre ishte Cikoja, që edhe ai u step. Çau-  
shi lëshoi një vërshëllimë të hollë e të zgjatur, si  
ato të gjahtarëve. Kafsha e njohu të zotin (atë

vërshëllimë e kishte mësuar qysh manar), blegëriu vajtueshëm dhe iu afrua.

Dashi tundi kokën leshtore dhe e futi atë në gjoks. Sakaq Çausi e kapi nga këmbët, e hodhi në krah dhe nisi të largohej nga kopeja. Disa dele blegërinë në kor.

Menjëherë, sa ndjeu erën e leshit, filloi t'i ngrohej trupi, iu përtëri ndjenja e dhembshurisë për kafshën. «Eeeeh, s'u ndake kollaj nga bagëtia!» psherëtiu.

E uli dashin përtokë. Hoqi thikën nga brezi dhe ia mbështeti në damarët e qafës. Sytë e tij u bulëzuan dhe valë drithërimash i kaluan në trup. Qëndroi për pak kohë në mëdyshje dhe më në fund e preu, e rropi dhe e futi në thes. Do të kaloj nga udha lart, tha dhe nxitoi hapat. Trupi i qe djersitur, ndërsa në hojëzat e hundës i vinte era e gjakut. Nga një gëmushë u ndien cicërimat e disa zogjve të vegjël, të cilët ende ishin lapurakë dhe shtrëngoheshin rreth krahëve të nënës së tyre.

Dëgjoi zëra. Qëndroi në vend. Po frynte erë dhe aty-këtu rrëzoheshin gjethe të përhimta pemësh. Mërmëriti. Shau nëpër dhëmbë dhe u kthye nga një udhë tjetër. Kjo ishte e mbuluar nga pemë frutore e drurë të tjerë po, që të arrije deri te shtëpia e tij, duhej kohë. Po të nxitoj, arrij me të feksur, mendoj dhe u sul me vrap. Nuk bëri dot as pesëdhjetë hapa, kur dëgjoi rrahjet e një sëpate. Dikush ishte ngritur herët e bënte dru.

Caushit iu drodh zemra. Qëndroi përsëri në vend. Bulëzat e djersës në ballë iu dyfishuan. Dora që mbante thesin iu mpi. Diku në rrëzëshpatullën e djathtë i erdhi për t'u kruar. Ai futi dorën nën roba, e lëvizi disa herë poshtë e lart. Derisa nga thonjtë e ngulur në lëkurë ndjeu dhembje. Go-

ditjet e sëpatës po i vinin më qartë në vesh. E, si për inat të tij, ato e goditnin drurin shumë ngadalë. Akoma më ngadalë zvarriteshin në trurin e tij. Ohu! Ky do gjashtë sahat ta presë atë dru, tha. Zbriti më poshtë. Ndjeu zhurmë hapash. I bëhej se çuditërisht po afroheshin.

Drita e mëngjesit u përhap me një heshtje tinëzare. Korente të ftohta ajri i prekën ballin. I shkuan të rrëqethura, goja iu çapëlye dhe thirri: «Më zunë!» — dhe mbylli sytë.

U përmend. Tutje shqoi dy trupa të bashkuar. Dy të rinjtë, duke menduar se kaq larg fshatit s'do t'i shihte askush, bisedonin me zë të lartë. Vajza e Demos, ka mbaruar edhe kjo të mesmen, tha duke u përkulur. Ajo duket e gëzuar, bën dashuri! Po vajza ime? Ajo çalon... Veç ka zemër të mirë, të pastër. Më kanë thënë një-rëz që e ke të mirë vajzën. Të mirë e kam! Të mirë?! Ah, ajo këmba...

Nga veshi i majtë i erdhi një llokocitje uji. Ai qe shumë pranë Burimit të Saliut. Shkoi atie dhe lagu fytyrën. Një mëllenjë e trembur klithi fort dhe fluturoi tutje.

Burimi i Saliut mbante ujë të ftohtë. Ujërat shkisinin butë mbi disa gurë të bardhë, të rrethuar anash me myshqe, e më tej bënin gurgule në ferra e barishte. Nga ana e djathtë e burimit ishte një guvë, si gojë e hapur, që mund të nxinte një nieri. Brenda në guvë, nga lart, binin pareshtur pikëza uji, ndërsa nga një e carë e saj uji dilte si shatërvan, duke krijuar vazhdimisht erë. Hyria e guvës qe e mbuluar me kulpër.

Caushit i shkëlloven sytë dhe e mblodhi veten. Mënianoi shpejt kulprat dhe futi thesin në guvë. Pas një copë here u nis përsëri për në shtëpi.

Kaloi një ditë dhe askush nuk dinte gjë të saktë për dashin. Disa thoshin që atë e kishte



garë bisha. Disa të tjerë nuk e pranonin këtë mendim po sillnin lloj-lloj hamendjesh.

Plaku Boro ziente nga zemërimi. Ai tregonte se afër mëngjesit kishte dëgjuar poteren e rezervuarit, që fshatarët e quanin pihua. Dhe i shkoi në mendje se ai nuk qe mbyllur mirë. Gjynah, do të mbytë bostanet, kishte thënë dhe kishte shpejtuar për ta mbyllur. Atje u lodh ca. Druri që mbyllte të vetmen vrimë të pihoit ishte hequr. Ishin hequr edhe dy gurët që e shtrëngonin atë dhe uji dilte me turfullim jashtë.

Boroja e mbylli pihoin dhe shkoi te dhentë. Kopeja kulloste qetë. Kur zbardhi dita, ai, si çoban i regjur, e ndjeu mungesën e Cikos.

— Bisha nuk e ka ngrënë, se dhentë nuk dukeshin të trembura, — tha ai.

— Mirë thua, atë do ta këtë marrë njeri. Apo mos qe sëmurë? — foli Bineri.

— Bah! Qe shumë mirë.

Bineri bisedoi edhe pak me Boron dhe u nda prej tij. Tej, në rrugë, dëgjoji që dikush po bënte fjalë me nënkryetarin e kooperativës.

— Dashin nuk e ka ngrënë bisha!

— E ka ngrënë dhe pikë, — e çonte zërin nënkryetari.

— Dëgjomë mua, dashi është marrë nga dorë njeriu. S'ka si të humbasë plaçka pa nam e pa nishan!

— Nuk merr njeri dash te ne!

— ... marrë njeri.

Zërat u shuan dhe Bineri shau me vete.

Rrugën për në qytet Çaushi e bëri gati me vrap. Ende në vesh i buçitnin fjalët e bashkëfshatarëve, të cilat zgjateshin me një notë pikëlli-

mi në fund: kush e vrau?.. është armik ai që vjedh!... Dhe që sfilitur shumë këto dy ditë Çaushi. Çdo gjë i dukej e huaj, e largët, e panjohur. Edhe njerëzit e shtëpisë i dukeshin të huaj. Fëmijët rrinin si të trembur para tij. Ata s'dinin gjë, po shikonin fytyrën e të atit të pikëlluar dhe bëheshin të urtë. Bile, edhe kur bëheshin gati ta pyesnin, ndeshnin në vështrimin e tij luteshëm dhe heshtin. Veç gruaja e mori vesh të fshehtë. Ajo e ndiente që burri po vuante dhe i vinte keq. E donte atë deri në dhembje. Kishte kaluar një jetë të tërë bashkë, pa u grindur. Ishte i njëzetepesti vit që prej asaj dite kur ajo kishte ardhur në këtë fshat dhe e kishte lidhur jetën me Çaushin. Dy ditë e dy net udhëtuan të dy bashkë, shaluar mbi kalin grivë. Dy veta dhe kafsha. Asnjë dasmor tjetër, asnjë tingull kënge veç cicërimave të zogjve, sepse ai e kishte rrëmbyer atë. Kur qenë larguar shumë nga fshati i saj, ai i kishte thënë: «Ka filluar martesë» dhe e kishte puthur në flokët e zinj. Pastaj ata jetuan bashkë, rritën fëmijë dhe ai la vazhden e njeriut të punës, të njeriut të ndershëm, që i bënte të dy të lumtur. Prandaj ajo u çudit me të; ishte hera e parë që i shoqi vuante kështu, diçka e mundonte dhe e ndrydhte brenda vetes. Oh... Mbrëmë ajo u zgjua papritur, nga një prekje e lehtë. Ai, me duart që i dridheshin po e mbulonte.

— Ç'ke, — i foli ajo.

— Ç'kam bërë, ç'kam bërë...

— Ç'ke bërë?

— Ç'kam bërë, — mërmëriti ai dhe shtrëngoi më tepër nofullat, si të mbante të koracuar të fshehtë. Ai e kuptonte shqetësimin e së shoqes, po vështrimi i tij thoshte: Mos më fol, mos më pyet!...

Çaushi vazhdonte të ecte. Një grup vajzash, rrotull një akacieje të madhe, bisedonin me zë të lartë. «Më duket se flasim për mua», tha me vete. Patjetër për mua. Këtë herë e shkela. Jam bërë helaq. Thua të jenë të vërteta ato që më tha kushëriri?!»

Arriti para dyqanit: «Cigare». Qëndroi disi mënjanë, sa i parakaluan disa njerëz, dhe u af-rua. Përballë tij, futur mes xhamllëkut që shkëlqente, qëndronte një vajzë. Ai e kundroi i habitur nga koka te këmbët, kundroi edhe buzëqeshjen e saj të vazhdueshme dhe e pyeti:

— Ku është shitësi?

— Shitësi?! E kanë hequr, — ajo përsëri buzëqeshte.

— Si? Kush? — u ngatërrua Çaushi dhe mbi ballë iu shfaqën djersë të ftohta.

— Drejtorja, — tha shitësja.

— Po Nebiu? Nebiu. A vjen një Nebi këtu?

— Çfarë është ky Nebi? S'di gjë unë, — tha ajo, teksa po rregullonte diçka nëpër sirtarë, përsëri kukuriste lehtë.

Çaushi nuk foli, por e shikoi tinëzisht në ninëzat e syve, si për të zbuluar njeriun e padukshëm Nebi. Tinëzisht shikoi edhe poshtë, te këmbët e buta e të bardha të vajzës me thonj të gjatë, futur në shapka plastmase, me mendimin se ai Nebiu fshihej për një grimë herë, sa të stepte tjetrin, dhe befas çonte kokën e paqafë, ngrihej rrëmbimthi i tëri, mbështeste kërthizën mbi xham duke krijuar të papriturën e këndshme. Ose, ja, ai mund të vinte edhe nga zyra: në fillim me hapa të shpejtuar; kur vërente atë që kishte hall të qëndronte para dyqanit «Cigare», i ngadalësonte ata, avitej pak nga pak, i përsëriste shenjë shitësit dhe hop të mbyllte sytë: kush jam unë, më gjen dot, gjemë, hə, gjemë, se nuk të lëshoj...

Çaushi u tërhoq prapa. Diku në dyqan, në krah të majtë të shitëses, ishte formular me shkrepëse shkronja «V». Vjedhës, sikur thërriste ajo. Zëreni vjedhësin, kapni grykën e thesit, kapeni në grykë, te kombi, tek ajo lajthia që s'leviz dot nga damarët e kuq... Ai u trondit, ndjeu sikur e qëlluan fort në zverk e në kreshat e supeve, e shkundën sa majtas-djathtas, po nuk ra. Më tepër se çdo gjë në këtë çast dëshironte të ulej. Të ulem, të shtrihem mu këtu në asfalt e të mbledh kockat, sikur folën buzët e tij pa zë. Të fle një herë e mirë! Të paktën një orë pa zhurmë! Këtë muai jam lodhur shumë, kam degdisur gjumin, fëmijët. Edhe jam plakur. Vjedhja të plakërka, të këruska..

Si pa u ndier, u fut në lumin e njerëzve. I merreshin këmbët dhe bënte ca lëvizje si somnambul. Fuu-u — ia bënin mendimet — erë në trurin e tij, fërfër — i shkonin e i vinin korente dridhmash në trup. Pesha që mbante në krah, i rëndonte tepër, por akoma më tepër e vriste në krye, në shpirt. Para syve, përskaaj e pas shpine, lëviznin njerëz të nxituar. Ata vinin edhe rreth e rreth, valë-valë, dhe atij i dukej se nuk do të mundte t'u përvidhej dot. Pas pak dëgjoi borinë e zgjatur të autobusit urban, britmat dhe fërkimin ngjethës së rrotave.

— Hiou, se të shtypi! — foli një zë dhe një dorë e tërhoqi me të shpejtë. Çaushi u plandos përdhe si i'alivanosur, këmbët i hoqi zvarrë dhe mërmëriti: «Të më shtypte, do shpëtoia!»

Hapi sytë e lagësht dhe pranë tij ishte Bineri. Atë çast i theri në trup, fjalët i gëlltiti dhe tundi kryet me dhembje.

E deleguara e Komitetit Qendror e përfundoi fjalimin. Shpërthyen duartrokitje. Sytë e mallëngjyer të Binerit lëviznin sa andej-këtej, shëtitnin mbi kryet e njerëzve. Hera-herës shikonte edhe fëmijë të vegjël që mbaheshin lart nga nuset e reja dhe përplasnin doçkat e njoma. Kaq donte Bineri që të tjetërsohej; një ngjyrë e veçantë e ndezur i lodronte në fytyrë, saqë kush ta shihte, do t'i përsëriste se dukej i ri dhe atij do t'i vinte vërtet mirë.

Më pas e ndali vështrimin te Çausi, që edhe ai po duartrokiste. Këtu në festë njerëzit janë të gëzuar, tha me vete ai. Edhe në punë janë të gëzuar. Luftojnë për jetën, për të mirën. Edhe ti, Çaus, e gëzon festën, përplas duart! Vajza në shtator do të mësojë për infermiere. Gëzo-hu! Lufto edhe ti dhe t'ia dish kësaj jete.

## *Një tufëz me lule*

1

Pranë thasëve me sumak, poshtë, te fusha e druve, bënte rojë Samiu. Unë, lart në mal, mbushja thasë, ndërsa tre kafsharët i zbritnin poshtë.

Punoja vetëm. Sumaku ishte i tharë, pasi e kishim hapur qysh më parpara. Mali ishte i zhveshur. Aty ku nderëm sumakun, kishte bli-re, prandaj edhe vendin e quanin Blinja.

Përveç që mbushja thasë me sumak, bëja edhe punën e intendentit. Merrja qumësht dhe farë kosi në një stan afër nesh dhe mpiksja kos. Kafsharët hanin bukë shpejt e shpejt, ngarkonin kafshët dhe niseshin. Në një shishe ata merrnin kos për Samiun.

Është mëngjes. Dielli ka kohë që ka rënë. Kafsharët janë nisur që me të zbardhur të ditës. Mpiksa kos dhe fillova të mbushja thasë. Punoja shpejt që t'i mbaroja sa më parë dhe se doja të rrija me Samiun.

Kur kafsharët erdhën për rrugën e dytë, kisha mbaruar gjithçka.

— Qenke bërë gati për marshim! — tha Ademi, një burrë tridhjetë e shtatë vjeç, me krye të bardhë e me rroba kafe.

Unë bëra me kokë.

Hëngrëm bukë, ngarkuam kafshët dhe u nisëm. Qielli ishte i pastër. Zogjtë cicërinin pa pushim. Rruga ishte e zhveshur dhe anës saj kishte pemë të rralla dhe bar të gjatë e të dendur. Herë-herë dukeshin pirgje të larta me gurë. Kafsharët më treguan se ato ishin sinore për kullotjen e bagëtive.

Diku në një shkrep shkau një mushkë. Unë u trondita, po kafsharëve nuk u bëri përshtypje. Mushka nuk pësoi asgjë. U liruan vetëm dy thasë, që i shtrënguam.

Po bënim rreth tri orë rrugë, kur Ademi thirri:

— Oburra, se arritëm! Ja ku është Samiu, ka hipur në majë të thasëve.

Përpara na u shfaq qyteza e gurtë, që gëlonte nga njerëzit. Ajo qytezë, ngaqë shtëpitë janë afër, ngjante si të ishte vetëm një shtëpi e madhe me oborr.

Shkarkuam thasët dhe kafsharët u nisën. Don-te edhe një litar dhe dielli hynte. Nisi të frynte erë. Tej, te kodra, fëshfërinë lehtas degët e pishave.

Samiu u ul mbi gur, duke u mbështetur mbi thasë dhe nisi të hante bukë. Ai është gjashtëmbëdhjetë vjeç. Për moshën që ka, duket mjaft i rritur: trup të gjatë e të mbushur, fytyrë të rrumbullakët me push të hollë dhe flokë të verdhë. Po mbush ca muaj që punon në bujqësi. Ndërkohë ndjek vitin e parë në shkollën e mesme bujqësore. Samiu nuk flet shumë, se nuk ka

qejf të flasë shumë. Ja tani ai ha qetë-qetë bukë.

Mbi ne fillon lagjja «Mente», me shtëpi të bukura, rrethuar me mure guri e me hardhi.

Rrija duke soditur një shtëpi dykatëshe me dy hyrje. Andej doli një vajzë me gjym në dorë. Ajo po vinte drejt çezmës.

— Do shkoj të pi ujë, — i thashë Samiut.

Ai ngriti kryet dhe më tha:

— Shko.

Ecja ngadalë. Dhe këtë e bëja që në çezmë të arrija njëkohësisht me vajzën.

Sa vente dhe afroheshim drejt çezmës. Tani dalloja jo vetëm tutat blu dhe bluzën e verdhë, por edhe fytyrën ezmore, flokët gështenjë, si dhe hundën e vogël pakëz të kthyer në majë.

Kur donim dhe pak metra të arrinim te çezma, vajza ngriti kryet lart dhe vështroi nga unë me bisht të syrit.

Duket krenare, thashë me vete dhe arrita pak më përpara te çezma.

Nga çezma rridhte një bilur i hollë uji mbi një magje, ku pinin kafshët. Era e lehtë shkëputte pikëza uji nga biluri dhe i shpërndante mbi pllakat e rrugës dhe këmbët tona.

Vajza s'e ngriti më kryet. Ajo vuri poshtë gjymin dhe hapi akoma më shumë rubinetin. Unë ndiqja lëvizjet e saj dhe dëgjoja llokoçitjet e ujit në gjym.

— Sa orë mësim bëtë sot? — pyeta, me një ndjenjë pavendosmërie, për të hyrë në bisedë.

— Nga e dini që unë shkoj në shkollë, — ma ktheu ajo dhe ngriti për një çast kryet.

— Kam edhe unë njerëzit e mi, — thashë kot.

— Keni njerëz...

— E, kam.

— Aha, na mbushe mendjen... — s'e mbaroi fjalën ajo.



— Foljen *mbush* ne e përdorim për thasë, bidonë, dyshekë. Për shembull: *mbush* thasë me sumak, vajza, që s'ia di emrin, *mbushi* gjymin me ujë etj., — thashë me seriozitet.

Vajza qeshi fort. Pastaj, si të kujtohej, u skuq dhe u largua me hapa të lehtë.

Qëndrova për pak kohë i ngrirë. Sikur të isha statujë. Trupi m'u drodh dhe më dukej se diçka ndryshoi në qenien time. Ndryshoi, por unë s'po e përcaktoja dot. Ç'ishte vallë ky ndryshim? Çfarë lëvizi? Po trupi, pse dridhet?

Shkëputa mendimet dhe ngrita kryet lart. Ndërkohë vajza u fut te ndërtesa dykatëshe. Në sy më mbeti ende valëvitja e flokëve gështenjë nga era.

U ktheva te stivat e thasëve dhe Samiu ende mblaçitej. E shikoja dhe mendimet më mbuluan. Po ky a do ndonjë vajzë? A ka trokitur gjë dashuria? Ku ta diësh, mbase do. Dhe atë e mban të fshehur thellë në skutat e zemrës. Se ja unë, kisha mbushur njëzet vjeç dhe ndjenjat nuk më janë lëshuar kështu si sot. Thonë që dashuria nuk pyet. Thonë gjithashtu që dashuria qëndron kur bëhet e pjekur. Po unë, vallë, a jam në moshë të pjekur?

Fillin e mendimeve ma preu zëri i Samiut:

— Hajt, do ta kthesh këtë, — dhe më tregoi shishen me kos.

— Do ta kthej, se të ngelet qejfi, — thashë. Kosi ishte shumë i mirë, me aromë të këndshme, që sikur më ndillte të shkoja përsëri, me një frymë, te çezma.

Samiu shkoi për të larë shishen, ndërsa unë u shtriva mbi bar. Era pushoi. Dielli fshehu kokën pas maleve. Nga perëndimi dalloheshin re të imta po të kuqe.

Ashtu shtrirë, mendime të shumta më rrinin në mendje. Tani më dukej sikur ato nuk më rën-

donin vetëm mbi krye, po në të gjithë trupin.

Te fusha e druve po shkarkohej një kamion me rimorkio. Nisën të gërvinin prerëset e drurëve.

Erdhi Samiu. Ai më hetoi mirë e tha:

— Dëgjo. Më pyeti një vajzë për ty. I thashë që ke mbaruar të mesmen.

— Po ti, nuk e pyete?

— E pyeta. Vazhdon gjimnazin pa shkëputje nga puna. Është në vit të tretë. Sot nuk qe në shkollë, se ishte me raport.

— Në çezmë e takove?

Ai bëri me kokë. Unë vazhdova:

— Ajo do të vijë përsëri në çezmë se do të ketë ende gjyma për të mbushur.

Samiu u ul afër meje. Rrinim pa folur. Shikimet tona kullotnin nga kodra me pisha, stivët e druve dhe shtëpitë.

Perëndimi po skuqej edhe më. Retë, të pudrosura me ngjyrë të kuqe, ngjanin si vurrata të gjetheve në vjeshtë. Në qytezë ishin ndezur dritat dhe tani, në këtë pragmbremje, dukej sikur ato loznin përzier me rrezet e hënës.

Samiu rregulloi vendin për të fjetur.

— Do dal, — i thashë atij, kur po shtronte disa mbulesa mbi bar.

Në rrugë kalonin njerëz me trasta në duar. Nga një shtëpi e ulët shpërndareshin jonet e një kënge. Ndoshta përgatitej koncert.

Qëndrova përpara dyqanit, që ishte në anën e një pallati trekatësh. Vallë, kush e bën pazarin në shtëpinë e vajzës? mendova. Dhe nuk kaloi as një minutë, kur tej, te rruga, po vinte vajza që sapo kisha njohur.

— Po ti këtu?! — tha ajo e skuqur, kur u afrua.

— Jam në hall, — thashë, — dua të bëj pasportizimin.

— Mos u mundo, se nuk ta bën njeri, — tha dhe shtrëngoi buzët për të mos qeshur.

— Përveç kësaj, unë këtu bëj edhe një punë tjetër: jap këshilla, po pa pagim.

— Meqenëse janë pa pagim, më jep edhe mua një këshillë?

— Posi. Mos shko më në çezmë, se do ftohesh. Dhe po u ftohe, doktori do të të japë përsëri raport. Kështu nuk do të shkosh dot as në punë e as në shkollë.

Ajo nuk foli po shikonte drejt meje. Sytë e hirtë sikur kuptuan diçka. Që të ngatërroja bisedën, thashë:

— Shoqe, më falni. Trasta juaj është gati të mbushet. Çdo vonesë ndëshkohet nga komisioni familjar për anën ushqimore.

Ajo qeshi me lot. Pastaj, kur pa njerëz, e qeshura iu pre në buzë, uli kryet poshtë dhe u fut në dyqan.

Me siguri qesh përsëri, mendova dhe u ktheva për te thasët me sumak.

## 2

Tashmë kisha mbetur vetëm. Samiun e thirrën në shkollë për konsultime. Vajzën e shikoja gati çdo ditë. Ikte në punë në mëngjes, më përshëndeste. Kthehej nga puna, shkonte në shkollë, përsëri më përshëndeste. M'u bë si zakon: doja çdo ditë ta takoja. Ashtu si unë, edhe ajo.

Pak nga pak po bënte dritë në zemrën time. Quhej Elsa. Kur bisedonim, ajo shpesh skuqej. Mbase e kishte zakon. Apo iu bë zakon. Ras-

ti e sillte që edhe të mos takoheshim. Dhe ato ditë unë e dija se ç'vuaja. Megjithëse kisha ngushëllimin: një tufëz me lule vjeshtake. Ato lule ajo i vendoste në një cep të shtëpisë dykatëshe. Këtë e dinim vetëm ne.

Po vinte vjeshta, po me hapa të ngadaltë. Pemët, në pjesën më të madhe, ruanin gjelbërimin, vetëm disa gjethe të verdha binin në tokë si me përtesë.

Atë pasdite shtatori Elsa kthehej nga puna. E takova në rrugë.

— Keni marrë ujë për sot? — e pyeta.

— Nga ta di unë, — tha ajo dhe priste se ku do të dilja.

— Me siguri s'keni marrë. Gjymat vetëm ty të presin.

Ajo vuri buzën në gaz dhe vazhdoi rrugën. Patjetër do të vijë, mendova dhe mora rrugën për në çezmë.

Pas pak ajo erdhi. Kishte hequr xhakëtën dhe në pah i dilte bluza vishnjë. Nisëm të bisedonim. Elsa herë pas here qeshte dhe ndërkaq gjoksi i hovte përpjetë. Ka diçka brenda që do të dalë jashtë, mendova.

U harruam në biseda. Gjymi ishte mbushur dhe uji derdhej furishëm mbi magje. Elsës për një çast i mbetën fjalët në buzë dhe mezi shqiptoi:

— Vëllai!...

Drejt nesh po vinte vëllai i saj. Ai duhej të ishte tridhjetë vjeç. Kishte tipare të ashpra: fytyrë me tëmtha të kërcyer, flokë të sertë dhe krahe të fuqishëm, që dalloheshin nën rroba. Padashtur mbloodha grushtet dhe dëgjoja hapat e tij.

Ndërsa shtrëngoja grushtet, nga ana tjetër mendoja se ç'përgjigje do t'i gjeja vëllait të Elsesi. Çfarëdo shakaje që të jetë, tiparet e tij nuk

butësohen aspak, por më tepër ngurtësohen (..sikur një herë të më shtrëngojë, më bëri kallëp sapuni). Kur ai u afrua, unë fola me zë të lartë:

— Nuk të ndihmoj dot. Në matematikë kam qenë dhogë për vete. Me atë mësues nuk ujdiset. Ai ka mundësi që edhe ëndrrat t'i shohë me integrale e derivate.

Vëllai i Elsës (tani qëndronte në vend), që e dëgjoi ligjëratën time, çeli pakëz buzët. Mua m'u duk sikur ai u butësua disi. Mund të thoshtë ndonjë gjë, po nuk foli. Ndërkohë grushtet e mia u hapën dhe u lehtësova.

Elsa më shikonte në sy. Ajo kishte shumë për të thënë, por s'tha gjë. Mori gjymin e mbushur dhe u largua me vëllanë, duke më përshëndetur. Nuk më kujtohet kush ka shkruar për peshën e fjalës, por tashmë e pashë vetë.

Një darkë ajo erdhi në vendrojnë time prej sumaku. Vendin e kisha bërë si kuvli. Gjithë atë ditë fryu erë jo shumë e fortë. Aty, tek rrimin ne, rrezet e hënës nuk na binin.

Atë darkë më shumë heshtëm, sesa folëm. Përbrenda më zienin mendimet, zemra më hovte. Heshtjen e mbushnin fëshfërima e pishave dhe kujisjet e zvergura të disa qenve.

Elsa uli kryet poshtë. Dhe ajo do ta mbante akoma, por unë fola:

— Dëgjo, Elsa!.. — dhe zëri më doli i dredhur.

— Të lutem, mos... — tha ajo dhe mbushi sytë me lot. I lëmova flokët dhe ashtu, duke e kundruar, ndjeva keqardhje. Kushedi ç'mendime i buisnin në krye, Kushedi si fërgëllonin flatrat në zemrën e saj. Kushedi...

— Ti qan, — thashë pas pak.

— Jo, — tha dhe fshiu sytë me gishtërinj. Dhe pastaj sytë e hirtë ndritën të rimbushur nga mirësia. Çdo gjë, kur lahet, ndrit, mendova.

Brigada e fshatit tonë shkoi përsëri në mal për të mbledhur sumak. Pjesa më e madhe ishin gra e vajza e të tjerët djem. Disa moshatarët e mi më tregonin plot gjëra për aksionin në mal. Prandaj dëshira për të shkuar më shtohet. Po, nga ana tjetër, kush do të rrinte rojë? Kjo më brente.

Një ditë vendosa të shkoja. Rojë do të rrinte Ademi, më i vjetri i kafsharëve. Për vajtjen time e dinte edhe Elsa. Kisha dëshirë të shkoja me të. Po s'dihet ç'pengesa dilnin, ndaj nuk e bëra të gjatë. Elsës sikur ia kishte qejfi.

U bëra gati për t'u nisur, ndërkohë vjen Elsa dhe më thotë:

— Mos shko!

— Pse, mos më është ngritur kurth?

— Ohu, me një mendje ti! Mos shko sot, po nesër. Babai, nëna dhe vëllai do të shkojnë në dasmë. Unë mbetem vetëm.

Kjo gjë për mua qe fare e papritur. Njeriu para të papriturave mund të hutohet. Por unë më shumë u trondita, sesa u hutova. Ishte një tronditje e këndshme, që ma mbushte trupin me gjilpëra. A ju kujtohet ajo kënga popullore që thotë:

*Gjilpëra, gjilpëra  
ma bëre vuxhunë,  
dal, o bandill, dale,  
sa të rritem unë...*

Ja, kështu më ndodhi edhe mua në ato çaste.

E vështrova me dashuri, diç pëshpërita nëpër dhëmbë, tunda kokën dhe u largova. Duhej të takoja Ademín, t'i thosha që të niseshim të nesërmen në mal.

Dhe Ademi lutjen time e pranoi. E pranoi pa më pyetur për arsyen. Në këto çaste doja të përqafoja edhe Ademin flokëverdhe.

Të nesërmen ishte e diel. Me Elsën e pleqëruam punën. Atë të diel bëri ngrohtë. Dielli ngrohu qysh në mëngjes. Kodra e pishave që mbushur me meloditë pambarim të zogjve. Qielli kishte marrë ngjyrë rozë në blu.

Kur erdhën kafsharët për rrugën e dytë, qielli në perëndim kuqëlonte. Një purpur me gjithëfarëlloj nuancash e kishte përfshirë të tërë atë anë të horizontit. Dukej sikur ai purpur i ndezur rrinte lehtë mbi kryet e maleve të perëndimit.

U hipëm kafshëve dhe u nisëm. Elsa hipi mbi Kukushen, mushkën më të urtë. Kafsharët thoshin barceletat. Murati, një djalë i gjatë e i zhvilluar nga trupi, kur nis nga barceletat, nuk mbaron.

Errësira hodhi mbulesën e zezë në të gjithë vendin. Filloi erë. Në hundë na guduliste era e barit dhe e pishave të sapombjella.

Në Blinja flakëronte zjarri. Fshatarët kishin filluar të hanin bukë. Edhe ne u zbritëm kafshëve dhe iu afruam sahanëve. Të gjitha vështrimet u drejtuan nga Elsa. Unë thashë:

— Vajza e dajës.

Pastaj vështrimet sikur u tretën, megjithëse disa shikonin me dyshim. Ndoshta mendonin për ardhjen e saj në mal. Ndoshta...

Elsa hante përsësh me kos e druajtur. Ajo hante me Arifenë, një bullafiqe e shkurtër e me flokë të gjatë, që ishte fqinja ime. Sakaq dikush foli:

— Denduni mirë me qumësht që të zini mullë!

Qeshën disa vajza. Pas ca e qeshura i pushtoi të gjithë, qeshnin duke nxjerrë tinguj të ndry-

shëm: herë mekeshin duke mbajtur barkun me dorë, herë kolliteshin e herë nxirrnin nga goja thërrime buke.

Mbaruam bukën. Yjet ndritnin dobët dhe nata ishte e errët. Zjarrit i hodhëm dy krahë të mirë me shkarpa të thata. Ndërkohë nisën tingujt e fizarmonikës të shoqëruar me def. Murati hipi mbi një gur, vendosi qetësi e tha:

— Fillojmë mbrëmjen. E çelim me një valle popullore!

Të gjithë sa ishim, u, ngritëm në valle. Ne kërcenim rreth zjarrit, ndërsa flaka e tij lëpihej në terrin e natës.

U ngazëlleva në shpirt. Fytyrat e fshatarëve të mi qenë të çelura. Në mendje më buisën plot mendime të bukura. Ja si është fshati im, Elsa, kështu janë fshatarët e mi! Njerëz të urtë e të zgjuar, njerëz pa qibër, njerëz që mund të mbajnë në duart e tyre edhe malet bashkë me ne të dy. Shiko, shiko si hedhin valle në flakët e zjarrit!...

Ndriste vendi nga zjarri ynë, nga fytyrat e zemrat tona, gjëmonte nga gazi dhe hareja. Dhe ky gaz, kjo hare shpërndaheshin në majëmale.

Herë pas here shikoja Elsen. Për çdo gjë mund të ishte e druajtur, po për mbrëmje jo. Ajo tani ishte harruar në valle. Sytë e hirtë i vetëtinin. Vinte pranë meje e nuk fliste. Flisnin vetëm sytë e saj.

Murati mbajti përsëri qetësi e tha:

— Valle popullore për ata që realizuan sot nga pesë norma dhe ata që hëngrën pesëmbëdhjetë kupa kos. Hajde, valle e rëndël! — dhe priu në krye të saj.

Shtrenguam duart dhe ende qeshnim. Murati në valle e sipër, thoshte ndonjë shaka tjetër.

Vonë e premë mbrëmjen dhe ramë për të fjetur.



## *Boro Korbeci*

Boro Korbeci qëndronte mbështetur pas trungut të plepit, ndërsa dhembja e dhëmballës po i shtohet. Ai ka fytyrë të madhe, të kuqërreme, me tëmtha të gropuar. Në pamjen e tij të ashpër vetëm sytë e butë, ngjyrëhiri dukeshin sikur rrezatonin ngrohtësi. Megjithëse ishte plak, punën nuk e kishte lënë, Përsëri punonte dhe që njëri zemërbardhë. Shtëpinë e kishte plot: gjatë jetës bëri tetë fëmijë si «yje», që tani nuk u flisje dot ashtu, pasi qenë bërë burra.

Mbrëmë, sa mbylli sytë, u zgjua papritur nga një dhembje e fortë në nofullën e poshtme; aty ku mbaronte cepi i mustaqeve të bardha, një dhëmballë nisi ta shqetësonte. U çua ngadalë nga shtrati që të mos bënte zhurmë: «Janë të lodhur fëmijë, natën ikën në punë e natën vijnë. Mbi gjithë hallet, rrinë edhe në sallë të kulturës, për një maskara që shpif», mendoi.

E mbushi gojën me raki e me kripë, po përsëri dhembjen e kishte.

Ndërkohë u zgjua plaka. Ajo u habit kur pa të shoqin, kryeulur, rrëzë bufesë.

— Ç'ke, o plak? — foli ajo ashtu e përgjumur.

— Hiç, po fli.

— Si hiç, ç'ç ke ti!

— Asgjë. Më dhemb pak një dhëmballë, — dhe tregoi vendin ku i dhimbe.

— I hodhe kripë e raki?

Plaku bëri me kokë. Më vonë, si u mendua, tha:

— Ku është dara?

— Shih, shih! Mos të merr perëndia mendjen dhe e krren me të. Lërna rehat, o plak. Shtrihu e hiqe nesër te doktorët.

Plaku, si me mëdyshje, u shtri. Mendimet i zienin si grerëza.

— Ç'kanë me Hamzën? — thirri befas. — Të gjithë flasin mirë, se punon mirë. Por është edhe ndonjë zemëkatran që grin e shpif broçkulla. Nga është?! Kush është ai që shpif?!

«Këtej nga ky fshat ka ardhur letra anonime!» — tha në fillim shoku i komitetit që kishte ardhur për verifikim.

«E pamundur, është djalë punëtor, e njohim mirë Hamzën», — ia kthyen disa fshatarë.

«Jam një banor nga Alpati. E ndiej si detyrë t'ju vë në dijeni», — lexoi për të dytën herë shoku i komitetit. Më pas ai foli për vigjilencën. Ja vetë do ta gjeni këtë njeri-enigmë», — shtoi ai. Sakaq çohet një nuse e re dhe merr fjalën:

«Kam qenë para ca kohësh në poliklinikë për të vënë një dhëmb. Ashtu rreth e rreth, dentisti më foli për kunatën e Hamzës. Kunata është burrvëdekur, ama e re, tridhjetë e pesë vjeçe. Ai, Hamza, çoku mbledhet edhe nga shtëpia e saj se, helbete, e zuri halli, më tha ai. Unë e

vështrova me inat dhe ai e qepi gojën... Brigadierin e blegtorisë, që e zëvendësoi Hamza, dentisti e ka vëllanë e gruas. Mbase...»

«Këtë do ta shohim menjëherë. Prapëseprapë na duhen prova», — tha shoku i komitetit.

Këto i tregoi djali i madh Boros, mbrëmë, kur u kthye nga mbledhja. Dhe Boros nisi t'i dilte para sysh Hamza, me atë fytyrë të ëmbël, me atë trup të drejtë e me kokë të vogël si dardhë. Ai e njihte mirë atë, e njihte që të vogël, e bile që në atë moshë e çmonte si djalë të zgjuar e çapkën. Tridhjetëvjeçar, Hamza u regjistrua në shkollën e mesme për zooteknik (kaq ishte dhe mesatarja e moshës së pedagogëve që jepnin mësim) dhe romuzeve të ndonjërit dinte t'u përgjigjej me lezet. Katër vjet rresht zbriste nga stanet e jepte provime. Mbaroi shkollën dhe shokët e kryesisë e propozuan përgjegjës sektori. Përgjegjës sektori fill pas mbarimit të shkollës? Jo, jo, këtë detyrë nuk e kishte pranuar Hamza. Atëherë brigadier blegtorie, i thanë. Mirë. Pesë kopetë me të imta që drejtonte ai realizuan për herë të parë planin. E lavdëruan Hamzën, e bënë shembull në kooperativë, në rreth, e çuan edhe në rrethe të tjera. Kur fët, hapet fjalë se ai vente me të shoqen e vëllait të sapovdekur! Vihet në pozitë burri i botës. Sos tënga e vëllait të vetëm (para gjashtë muajsh e mbuloi me dhe), sos fjalët poshtë e lart, sos hallet e punës. Dhe nuk mblidhet Hamza në shtëpi, u vidhet syve të njerëzve dhe e kalon natën stan më stan. Ta shihje atë tani, zor se do ta njihje, sepse ishte dhe i gjatë nga trupi dhe hollimi binte shpejt në sy. Andaj duhet kurajë, se, po u ligështove, mbarove. Njeriu i mirë patjetër ka forca të mira...

Me këto mendime plakun Boro e zuri mën-

gjesi. U ngrit nga shtrati, u rregullua dhe mbërriti në poliklinikë.

Poliklinika ishte një ndërtesë e thjeshtë, njëkatëshe, me çati konike, që zbardhonte nga sherbeti i gëlqeres.

Majtas zgjatej një plep i lartë, i gjelbëruar, ndërsa disa metra larg shtrihej deti.

Boroja rrinte i mbështetur pas plepit dhe prishte dentistin, që ende s'kishte ardhur. Dhëmballa i dhimbe, po nuk shtrembërohej aspak në fytyrë. Ai do ta kishte hequr vetë, po si t'ia bënte plakës. Asaj nuk ia prishte dhe as nuk i kundërshtonte, se qe e zonja, kishte bërë tetë fëmijë të mbarë.

Tej në rrugë u duk dentisti. Ai diçka po bisedonte me sekretarin e byrosë të kooperativës. Ndërsa sekretari nxitonte, dentisti i fliste duke i dalë herë nga një krah e herë nga tjetri. «Pse lëpihet ashtu?!» mendoi plaku sakaq.

Dentisti, që quhej Qazim, ishte trupgjerë e me kokë të madhe. Kur fliste, buzët i dukeshin sikur i përplaseshin dhe përskaj tyre i mblidheshin grimca pështyme.

Qazimi u shkëput nga sekretari i byrosë dhe përsëri fliste duke ecur mbrapsht. Pastaj u kthye para dhe shpejtoi për në poliklinikë. Plaku Boro e ndoqi pas.

— Ç'ke, xhaxha? — pyeti Qazimi duke hapur derën.

— Do shkul një dhëmballë.

— Ta shikojmë se mos mbushet.

— Lëri të trashat, po ke marifet ta heqësh?

— Ulu këtu, — dhe me dorë tregoi kolltukun.

— Të të bëjmë edhe një gjilpërë dhe të ta nxjerrim pa e ndër fare.

Në fytyrën e Qazimit endej një valë e lehtë skuqjeje dhe duart i lëvizte me nxitim. Një zog

përplasi krahët në xham dhe iku tutje. Qazimi e kundroi mirë plakun dhe e pyeti:

— Nga ç'fshat je?

— Alpati.

— Ishe në mbledhje mbrëmë?

— Jo, kur u ktheva nga stani, i gjeta në të mbaruar, — tha Boroja.

— Pse, punon akoma? Bravo, shtyllë e fortë ju pleqëria!

Boroja nuk foli.

Qazimi doli përjashta, qëndroi pak dhe hyri brenda me diçka fidanë specash e domatesh.

Plakut Boro një rreze drite i regëtiu. Gjoksi i gufoi dhe sytë sikur i lëshuan dëlirësi. Atij i erdhi mirë që edhe dentisti, qytetar, mbante specat e domate. «I duan bimët, e duan bujqësinë! Ndonjëherë më këndon djali gazetën: u realizua kaq çelik e aq grurë. Punojnë njerëzit, Punon edhe ti, Hamzë, po ç'kanë me ty?! Edhe ky dentisti punon, ka domate e specat. Kooperativa jonë i nxjerr fidanët e para. Ndaj i ka marrë ai, t'ua tregojë atje në qytet mallin tonë. Po këtij i shpifin?»

Ndërsa mendonte, i pushuar nga ndjenja të ndryshme, Boro nuk iu ndenj, po foli:

— Ç'i do ata?

— M'i dha një shok, pesëdhjetë qindarka një rrënjë. Kam një copë vend në shtëpi e do t'i mbjell. Se, kur duhen, nuk i gjen. — Qazimi qëndronte në mënyrë të tillë sikur të thoshte: «E shikon, s'e kam keq.»

— Më fal, o doktor, — foli qetë Boroja, — unë rrallë vij në qytet, se nuk më lë puna. Po, sa herë kam ardhur, dyqanet plot i kam parë.

— Plot, more, plot. Po ja, xhaxha, si të ta them, nuk ndahesh dot. Jemi mësuar keq; një çikë gjë për qejf duam ta bëjmë vetë. Tjetër

kur e blen e tjetër kur e bën vetë. Thujmë pakëz, u ndave ti nga bagëtia? Hë, fol, u ndave?

— Nuk u ndava...

— Aty më rri mua, — thirri me triumf Qazimi duke ia ndërprerë fjalën dhe qeshi me djallëzi.

— Dale, doktor, dale. Vërtet më dhembti kur e dorëzova bagëtinë, po fundi ku fle bagëtia? Ku fle lopa ime? Fle në stallë, ku mund të flemë edhe ne të dy. S'i ke parë stallat në fshatin tonë. Për bukuri janë, feksin nga bojërat! Të prehet shpirti kur i sheh! Unë, që thua ti, i kam dashur shumë delet. S'jam ndarë nga to, kam një jetë të tërë. Dhe nuk u ndava, u thashë shokëve e vajta çoban me tufën kolektive.

Qazimi nuk foli, po bëri gjilpërën. Boroja, si u lirua nga ai, uli sytë përdhe. E harroi dhe mbjen e dhëmballës. Rrezja e dritës që i regëtiu qëparë për dentistin, dalëngadalë po shuhej. Në trup sikur ndjeu diçka që kërciste lehtë-lehtë, gati për t'u thyer. S'dinte shumë Boroja. Përpara kishte vuajtur. Pastaj ndryshoi jeta e ndryshoi edhe ai. Kudo që të shkonte, do të thoshte «E shtymë fukarallëkun tutje» dhe trupi i ngazëllehej. Ai i donte dhe i respektonte njerëzit e mirë. Respektonte të shkolluarit. Më tepër çmonte të shkolluarit që merreshin me mjekësi. Të gjithëve, sa shihte nëpër spitale me përparëse të bardhë, ai «doktor» do t'u thërriste. Tepër besim për ta. Tepër! Ta çojë Boron edhe në pyllin më të dendur, nuk do ta humbiste toruan, veç në korridoret e spitaleve ishte ngatërruar nja dy herë dhe kishte qeshur me vete.

Boroja kujtoi bisedën me dentist Qazimin. «Le ta harrojë llafin që bëmë», tha aty për aty dhe u rehatua në kolltuk. Hodhi sytë përçark dhe fytyra i ndriti. Gjithë këto mjete, gjithë këto vegla për ne janë. Po. E kemi të drejtë ne të moshu-

arit që s'duam të ndahemi nga kjo jetë. Përpara s'pyeste njeri. Asnjëri. Tani të gjithë janë mirë. Eh, ç'bën kjo Parti! I uli akoma çmimet e ilaçeve... Rroni, gëzoni, o njerëz!

Kështu bisedonte me vete ai dhe një pikë lot si sumbull iu var në faqen e rreshkur. Vitet e fundit, kur kujtonte të kaluarën, si pakuptuar i bulëzonin lotët. E ashtu, me sy të përlotur, vinte buzën në gaz.

Pas pak gërviti dera dhe nga ajo u duk një kokë e shogët, me flegrat e hundës të hapura.

— Mos u mërzit, — i tha plakut Qazimi duke mbyllur sirtarët e një dollapi dhe dolí përjashtë.

Vendi ku Qazimi bëri gjilpërën u mpi. Boros i erdhi për cigare po nuk e ndezi. Nga prapa derës vinin pëshpëritje të mbytura.

Boroja nuk i ka qejf ata që përgjojnë, prandaj lëvizti pak nga kolltuku si për të larguar zërat. Megjithatë veshi i tij pipëz nisi t'i kapte zhurmat që vinin që përtej.

«Si bëre për atë?» — fliste kokëshogu.

«Ajo punë u rregullua. Bisedova me kryetarin. Të kam thënë, e kam shok. Në fakt, nuk ma tha plotësisht, po, me sa vërejta, puna mori fund. Me atë nam që iu hap Hamzës, zor se e mbledh veten. Patjetër do ta heqin si brigadier blegtorie dhe ti vete te vendi.»

«Të paça, o kunat!»

«Asgjë, vetëm të mira të bëjë njeriu...»

Ndërsa zërat prapa derës sigur u shuan, plaku Boro gati kishte ngrirë në kolltuk. Ai qe zbehur në fytyrë dhe dukej sikur nuk po i rridhte më gjak. Hera-herës i dridhej nofulla e poshtme, kurse mbi vetullat e kërlëshura rrudhat i qenë dyfishuar. Solli nëpër mend ato çka i kishte thënë djali kur qe kthyer nga mbledhja: «... Brigadierin e blegtorisë, që zëvendësoi Hamza, doktori e ka kunat,

mbase...» «Këtë do ta shohim. Prapëseprapë na duhen prova», tha shoku i komitetit. Prova, fakte?! Jua sjell unë faktet, se e dëgjova me këta dy veshë. Doktorin bën letra, shpif për Hamzën. Ky e ka bërë djalin të sëmuret, t'u vidhet syve të njerëzve. Mbani shënim! Këtë e bën për kunatin, për atë çitakun që m'i ka hundët si xelefka qepe! Pa dëndenin njëherë me dru, bjerini sa të vjellë gjak...

Qazimi hyri me vërtik brenda, përsëri tha: «mos u mërzit» e doli jashtë. Ndërkohë Boroja vështroi për një copë herë burrin kokëshog që i ngjau si i humburi në shkarpa.

«Mos na dëgjoi gjë plaku?» — tha kokëshogu.

«Kush, mo? — Hahaha! Ai është bërë treqind dynja.»

Ra heshtje. Pas disa minutash u dëgjua zhurma e një aeroplani, i cili shkaktoi dridhjen e fortë të xhamave. Përbri poliklinikës ishte fusha e aviacionit dhe prej saj herë-herë ngriheshin aeroplanë.

«E more vesh? Mbrëmë ata të komitetit kanë shkuar në fshat», zëri i Qazimit.

«Gjetën gjë?»

«Gjendemi ne? Nuk u vete mendia.»

Plaku Boro tashmë ziente përbrenda dhe s'e mbante më veten. Njëherë mendoj të ngrihej, t'i shkundte fort nga supet dhe t'i hidhte poshtë, se takatin ua kishte. Jo, jo, shtoi aty për aty, punët e mira bëhen me razillëk, me qetësi. Do vete te Partia, t'ua shkoqit mirë.

Pastaj shikoi nga dritaria. Tei gielbëronin arat me grurë, akoma më tei mbillei misër. Dhe iu bë sikur dikush i shkelte të mbiellat me këmbë. I shkelte, capitej pa zhurmë, si hite, dhe vetëm i shkelte. I shkelte për pak kohë, se ia përpara u del Boroja, u del ajo nusja nga fshati i tij.



dhe ai dikush mblidhej, ngucej... Plaku ndjeu keqardhje dhe urrejtje njëkohësisht. Jeta kishte buitur me aq bukuri nga çdo anë, dhe dikush mundahej ta prishte atë.

Qazimi hyri brenda, mori darën dhe iu afrua plakut. Ai e pa atë të dridhej dhe mendoi se plaku trembej. Qeshi nën hundë dhe me darën në dorë qëndroi disi përpara fytyrës së plakut. Deshi të bënte një lodër, që e përsëriste përpara ndonjë miku të tij, duke krijuar për pak çaste atmosferë humori.

Plaku e shikoi vëngër (u duk sikur plakut i plasën kokërdhokët e syve), dhe dentisti i mëshoi dorës, buzëqeshi e tha:

— Shtyllë e fortë ju pleqëria!

Fjalët e Qazimit ia ngritën më tepër nervat plakut, që s'u përmbajt, por e pështyu në fytyrë dhe shfryu:

— Palo burrë, qen! — dhe e kapi fort në grykë. Duart e plakut, duke u dridhur, shtrëngoheshin në fyt, ndërsa Qazimi, i ndodhur përpara këtij shpërthimi të papritur, shtangu në vend dhe i ngriu buzëqeshja.

Boroja erdhi në vete dhe e lëshoi. E shikoi mirë nga koka në këmbë dhe qetë-qetë shtoi:

— Merr edhe atë çitakun, atë kunatin tënd, e dilni nga fshati se do t'ju këndojmë letrën. Dhe mbaje mend: vërtet jemi shtyllë e fortë ne pleqëria!

## *Kryetari i kooperativës*

Po bëheshin disa ditë që në atë kooperativë koordinore kishte filluar mbjellja e misrit. Nëpër arat e tetë fshatrave gumëzhinin zhurmat e automjeteve dhe zërat e njerëzve. Në dheun e ngopur nga snirat e pranverës dukeshin gjurmë rrotash, zinxhirësh, njerëzish e kafshësh.

Makina që binte në sy më tepër, ishte gazi i kryetarit të kooperativës, Lirim Kalesë. Lirimi kishte disa net që s'mblidhej në shtëpi. Tregojnë se, kur nisi punën si kryetar, ngrihej herët, shkonte në krye të arave dhe priste fshatarët. Atje fshihej diku dhe shikonte se me çfarë do ta hanin ata mëngjesin. Disa kishin kos, disa qumësht, vezë, po kishte edhe me gjizë, qepë e turshi. Lirimi kishte ndier dhembje. Që të bësh detyrën, duhet të hash, kishte thënë ai në mbledhjen e kryesisë... Tregojnë se njëherë shkoi për të kontrolluar ujitjen e misrit natën. Në parcelën e Shakavecit, dy ujitësit kishin futur ujin dhe

po flinin. Lirimi nuk i zgjoi, po mori shatën dhe ujiti për gjithë natën. Në mëngjes dy ujitësit kishin parë parcelën e njomur dhe kryetarin e shpërvëshur... Tregojnë..

Makina çante përpara dhe shoferi shtrëngonte fort timonin. Shpesh ajo bënte dëk-dëk dhe shoferi gjente rast për t'u ankuar: «Na u prish, s'ecën dot as një metër, e nxorën jashtë përdorimit.» Lirimi e shikonte në sy, e kuptonte domethënien e atyre fjalëve, buzëqeshte lehtë e, duke tundur kryet, thoshte: «Lëri fjalët. ec përpara!» Shoferi nuk ia kthente më, megjithëse i vinte ligisht për kryetarin, që këto ditë të fushatës nuk flinte më tepër se tri-katër orë. Herë-herë, nga pagjumësia, Lirimit i mbylleshin sytë dhe koka i vaisej mbi xhamin përballë a mbi shpinë të shoferit. Kjo vazhdonte për pak minuta, se ai përmendej e fliste: «Ah, zabërhan, po ikën si breshkë!» Shoferi buzëqeshte e ia kthente: «Më shove brinjët e më le kalamajtë rrugëve», Atëherë Lirimi fërkonte sytë me parakrah, drejtonte trupin e, për të mposhtur gjumin, ia fillonte bisedës:

— Sekretarin e byrosë e kemi djalë punëtor. Njëzet e pesë vjeç ishte kur erdhi në kooperativën tonë. Më parë kishte qenë komisar aksioni. U njoh me gjendjen, brodhi fshatrave, u takua me njerëz e më tha: «Kemi tërë ata kuadro të mesëm, disa duhet t'i vëmë edhe në drejtim. — E pamundur, ata s'kanë autoritet, i them. — Po shkencën me kë do ta bëjmë? Të rinjtë e marrin më shpejt të renë.» Natyrisht nuk u dorëzova lehtë. Aq më tepër, këtë s'e pranonin as disa kuadro të tjerë të vjetër. Por ai ua hëngri zemrën me të mirë. Kooperativa jonë filloi të dilte mbi shoqet.

— Të vjen keq që do të ndahesh? — ndërhynte shoferi.

— Ashtu, ashtu, — mërmërinte Lirimi dhe bëhej pus i thellë, heshte. Shoferi nuk i fliste më, por e merrte me mend që ai kuvendonte në heshtje me sekretarin e byrosë, që në shtator do të niste shkollën e lartë të Partisë në Tiranë.

Makina ndali përpara një rrapit degëgjërë, në krye të fshatit. Shoferi mbushi disa herë kovën me ujë pranë një çezme përbri rrapit dhe filloi ta pastronte makinën, ndërsa kryetari shpëlau fytyrën dhe po fshihej me shami. Sakaq ai dëgjoi që dikush e thirri. U kthye andej nga erdhi zëri dhe shqoi një grup plakash që kishin qarkuar banakun e dyqanit të bukës. Iu afrua dhe u shtrëngoi dorën. Pastaj takoi shitësen dhe brigadierin e blegtorisë, Bendisin.

— Mirë se erdhe, kryetar! Ç'kemi? Dukeni si i këputur. Unë po i ndih pak gruas për ndarjen e mishit, se burrat na i qërove të gjithë për fushatë.

— Besoj nga dy kilogramë mish për familje? — pyeti kryetari.

— Ëhë, nga aq, — tha shitësja.

— Bendis, po kopetë ç'thonë?

— Shumë mirë. Në kope kemi marrë edhe disa të rinj.

Kryetari u mat të dilte, po ndërkohë, si të kujtohej papritur, i tha shitëses:

— Ma jep pak dokumentin e mishit, të shoh llojin.

— S'patëm kohë ta çonim në magazinë. E prura me vërvimë... — tha Bendisi.

— Ashtu?! — kryetari u pre në fytyrë. — Ti e di mirë që mishi duhet çuar në fillim në magazinë!

— Thamë t'ua jepnim shpejt.. Kohë fusha-

te... E bëmë me ndërgjegje... — tha Bendisi.

— Mishin çoje urgjent në magazinë, pastaj shite! — tha fort Lirimi dhe doli. — Ikim, — i tha më pas shoferit dhe u mbështet në ndenjësën e pastruar.

Makina gulçoi. Shoferi nuk ktheu kokën ta shikonte, por ama lëvizjet e tjetrit i vinte re në xhamin e pasqyrës. Dallonte rrudhjet e buzëve dhe njëfarë dridhjeje të trupit të bëshëm.

— Më dëgjon! — thirri befas Lirimi dhe ndenjësja kërciti, — Bendisi brigadier blegtorie, e shoqja shitëse, po merre me mend çfarë mund të bëhet. Më janë ankuar disa veta për Bendisin, që s'mblidhet me bagëtinë, por unë s'i kam rënë pas, Ty si të duket?

— Bendisi flet mirë për ty.

— Hëm. Po, ai flet mirë për mua. Edhe atë mbrëmje në stanin e Vadiut Bendisi tregoi për babanë tim dëshmor. Atëherë u mallëngjeva. M'u mbushën sytë. M'u zunë, thuaj. Ta dish që Bendisi s'është në rregull. Ndonjë që e sheh, nuk flet, se mendon që e paska mirë me mua. Unë mallëngjehem.

Kryetari e preu fjalën. Atë çast iu kujtua një mbrëmje në shtëpinë e Bendisit. Po kuvendonte me djalin e tij pesëvjeçar.

«Xhaxhi, pse s'ke çorape leshi?» — i kishte thënë vogëlushi.

«Kam unë, kam», — i kishte lëmuar fytyrën ai.

«Çorapet bëhen me lesh. Qilimi bëhet me lesh. Ne kemi gjithë atë. Ja, shiko,» — vogëlushi kishte ngritur mbulesën e krevatit, ku dukeshin dy thasë me lesh.

Lirimi ishte dridhur. Ishte tërbuar nga zemërimi. Madje fëmijën e kishte parë me zemërim, si të ishte ai fajtori. Kjo kishte zgjatur disa minu-

ta, se Bendisi kishte hyrë në dhomë dhe i kishte zgjatur një album. «Janë dëshmorët e kooperativës, i kam mbledhur një e nga një. Te mesojnë fëmija, të hapin sytë», — kishte dëgjuar Lirimi zërin e Bendisit, teksa shfletonte. Ai ende ziente nga zemërimi, por ja, hap faqen e parë dhe përpara i del fotografia e babait, që ishte vrrarë në dhjetor të dyzetedyshit. Atij i qenë rrëmbushur sytë me lot. Fotografia e babait të tij ishte me përmasa më të mëdha, ajo u printe të tjerave, kishte edhe shënime...

«Përse më keni ndarë? Lërmëni me shokët, si shokë,» sikur i folën kryetarit sytë e pajetë të babait dhe diçka e paqartë ju tallazit në shpirt... «Duhet të merrem me Bendisin veçanërisht», mendoi ai.

— U bënë mbjelljet në kohë sivjet, — tha shoferi.

— Po, po, — kryetari lëvizi si të përmendej. — Na ndihmoi mirë SMT-ja. Pastaj çdo parcelë u mboll me specialist te koka. Kanë mbetur edhe njëzet hektarë. Tokat e tyre janë bërë gati për mbjellje, një duman duan dhe i vëmë përpara.

— Sot do flemë në shtëpi, — tha shoferi. — Gruaja ime më duket se ka filluar të ankohet. Lirimi qeshi dhe i hodhi krahun miqësisht.

Megjithëse kishte menduar që në shtëpi të shkonte më herët se zakonisht, më në fund arriti atje në orën njëmbëdhjetë të mërkurës. Shtëpia kishte rënë në qetësi, nënën dhe dy fëmijët i kishte zënë gjumi. Vetëm e shoqja ishte zgjuar. Në çdo orë që ai të vinte në shtëpi, do ta gjente atë zgjuar, me sy të mbufatur herë duke nxituar për t'i ngrohur gjellën e ftohur, herë për t'i ngrohur ujë, përherë e shpejtë, e pagojë, e brishtë. Në këto raste atë e mbulonin ndjenja të ngrohta, për

gruan, për njeriun e dashur, të cilat asnjëherë nuk ia shprehte dot, ia thoshte gjysma-gjysma, si t'i përtypte fjalët midis nofullave. S't'i them dot», mërmëriste duke e mbajtur pranë e duke futur fytyrën e saj delikate midis shuplakave të tij të gjera e të forta.

Gruaja i vuri përpara gjellën, që nxirrte shkullme të vogla avujsh, e ai, pasi u la, filloi të hante me uri. Pothuaj nuk fliste fare. Me sytë fiksuar diku, mbllaçitej shpejt.

— Tjetër gjë s'ke gatuar? Sikur kemi festë, — tha ai.

— Jo, — E shoqja mblodhi supet e buzëqeshi.

— Ma sill shpejt, pa e di unë.

E shoqja i solli një pjatë me kadaif.

— Gëzuar festën, — uroi ai.

— Sikur të ndjek njeri, — buzëqeshi ajo.

— Më ndjek gjumi, ndihem i lodhur.

E shoqja e preu buzëqeshjen dhe e shikoi në fytyrë. Ai dukej vërtet i lodhur, pak i hequr, me disa fshikje të holla mbi mollëza e si i pamundur. Ajo iu afrua dhe i mbështeti dorën mbi sup. Diçka e shpejtë i vërshoi në trup, një ndjenjë ku përziheshin së toku dashuria e dhembshuria. Edhe atëherë kur ajo ishte vajzë, sa kishte mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, i qe dhimbsur ai, me atë cigaren që e raste shtrembër, midis buzëve të trasha, dhe e thithte fort. Kjo ndjenjë ngrinte krye shpesh në qenien e saj, madje edhe tani që ishte grua me dy fëmijë dhe aty-këtu në flokët e gjatë e të zinj dallohej ndonjë thinjë.

— More mish mbrëmë? — tha ai.

— Kemi gjashtë kilogramë.

— Mos e ziej të tërë. Lëre pak që ta pjekim, se e kanë qejf fëmijët.

Ai u çua nga tryeza dhe filloi të zhvishej. E

shoqja ndërkohë bëri kafën e ia solli te shtrati. Ai surbi një gllënjë e papritmas pyeti:

— Pse gjashtë kilogramë?

— Aq na prunë.

— Si aq, racioni është dy kilogramë?

— Kaq gjeta në shtëpi. Ia kishin sjellë nënës. E solli Bendisi. Nëna...

— Ah! — skërmiti dhëmbët ai. — E di ti që Bendisi flet për babanë tim që u vra në dhjetor të dyzetedyshit? E di që ai shet mish pa faturim e unë nxehem me të? Le të nxehem unë, ai të thotë urtë e butë: «Mos u nxeh, zoti kryetar, se të kam çuar edhe ty mish. Ta çova kalëruar, mes për mes fshatit, hop, mu te dera e shtëpisë!»

— Nëna është sëmurë, — foli ajo.

— Si? — ai u çua nga shtrati.

— Mbrëmë s'vuri gjumë në sy. Vetëm tani, para gjysmë ore, e ka zënë gjumi.

Ai hapi lehtë derën e dhomës tjetër dhe iu afrua së ëmës, që dihaste thellë. Pas tij erdhi edhe e shoqja. Qëndruan pak atje e pastaj dolën të dy.

— E shikon ç'bën Bendisi, — tha ai. — Merr vesh që nëna ime është sëmurë dhe menjëherë bie mishin, si të jetë malli i tij. Nesër katër kilogramë coji në dyqan.

Ai u fut në shtrat dhe gruas. ashtu në errësirë, iu duk sikur të shocit po i zmadhoheshin bebet e syrit. Me siguri edhe këtë natë gjumi do ta zinte afër mëngjesit.



## *Net me hënë*

Ditët e para të shtatorit nisën me shi. Ai fillonte me turfullim në mëngjes, vazhdonte ditën, e aty nga pasdrekja dilte dielli dhe bënte vapë. Atëherë punoja në hangarin e duhanit. Tekniku quhej Minush. Ne punonim të dy deri në mbrëmje, dhe, ndërsa ai ikte në shtëpi, unë rrija në hangar si rojë. Në fillim u mërzita. Duhej të rrije gjithë ditën në këmbë, megjithëse ishin punë të vogla: në kubikë zgjidhja duhan të thatë dhe i bëja deng; vendosja thumba në kubikë, mbledhja fletëza të shkoqura në plastmasë etj. Gjithashtu isha i mërzitur edhe me një fshatarin tim. Kur u bë mbledhja e brigadës, brigadieri tha se duhej një rojë. «Ne, si shtab, kemi menduar të caktojmë Sokolin, duke i dhënë edhe pesëmbëdhjetë ditë pune», tha ai.

«Bah, hangari do zot, nuk do axhami», u hodh ai fshatari im.

«Cilin mendon ti?» tha brigadieri.

«Resmiun, se është i pjekur, ua ka marrë dorën këtyre punëve. Resmiu vete edhe me dhjetë ditë pune», tha përsëri fshatari.

«Avash-avash se na hodhe shkumët në surrat, — tha xha Minoja. — Ti flet kështu se Resmiu ta bëri lopën plakë, në grumbullim, mëshqerrë të re?»

Edhe të tjerët e kundërshtuan fshatarin që fliste për Resmiun.

«Sokoli të vihet rojë», tha dikush.

«Edhe unë jam dakord për Sokolin, ne jemi edhe komshinj e nuk ia prishim njëri-tjetrit», tha gjakftohtë Resmiu.

Të flas të drejtën, mua ma kishte qejfi të isha rojë. Në shtëpi qemë pak shtrënguar dhe mua më bëhej mirë që ditën të punoja e natën të isha rojë. Lekët që do të merrja si rojë, mendoja t'i mblidhja, pasi kisha vendosur që, para se të më merrnin ushtar, të fejohesha me Burbuqen. Po nuk ishte vetëm kjo arsyeja. Unë kam një dëshirë, mbase edhe të veçantë, dua të fle jashtë qoftë në dimër e qoftë në verë. Kam qëndruar disa net jashtë e mund të them se tek secila natë kam gjetur një bukuri që s'përsëritet.

Pastaj mërzitja më kaloi dhe u mësova me punën e re. Thosha: Si rri Minushi, burrë pesëdhjetë e pesë vjeç, në këmbë, ashtu të rri edhe unë. Minushi ishte njeri punëtor. Për punë të keqe ai nuk të falte, kushdo që të ishte.

Minushi më donte shumë dhe kuvendonte me mua si me një njeri të pjekur. Shpesh më thoshte: «Ke ngjarë në damar të babait.» Atij nuk i rrinte dora. Dhe pushimet për cigare i bënte të shkurtra. «Ka punë që kontrollohen vetëm me sedër», — thoshte. Ndonjëherë bënte shaka duke më thënë: «Je bërë për nuse. Unë do ta

djeg në dasmën tënde.» Atë çast më dilte para sysh Burbuqja...

Ditët kalonin si pa u ndier. Në mëngjes ra një shi i dendur, po në duhan nuk na bëri ndonjë dëm. Ishte e mërkurë. Po fillonte të errej. Shkova në hangar dhe kontrollova duhanin. U futa edhe nën kubikë dhe, si m'u mbush mendja që duhani ishte në rregull, u shtriva në shtrat.

Shtratin e kisha ndërtuar lart, që çdo gjë ta kisha si në pëllëmbë të dorës. Atë e bëra me merak të madh. Mbi degët e holla shtrova dyshekun. Përsipër e mbulova me plastmasë, si edhe me fier, për të mos u ndezur shumë plastmasa gjatë ditës. Shtratin e maskova plotësisht dhe, kur dilja prej tij, dukej sikur dilja nga ndonjë gëmushë e dendur.

Ç'kënaqësi ndjeva natën e parë! Ishte me të vërtetë një natë e bukur, që do të pasohej nga të tjerat. Drita e hënës thyhej në ato vende me plastmasë ku kishte rrëshqitur fieri. Shpirti m'u ngazëllye dhe në mendje më radhiteshin mendime të bukura.

Gjithçka rreth meje që zhytur në tisin e errësirës. Tej, në gji të maleve, vezullonin dritat e fshatrave. Ashtu, me varganët e dritave në sy, më kapulloi gjumi.

U dëgjuan lehje qensh dhe hapa sytë. Nxora kryet jashtë. Vendi ndriçonte nga hëna që sapo kishte dalë. Qentë ndiqnin pas një pelë të kuqe, me vithe të gjera, që po kulloste afër hangarit. Ajo ishte pela e Aliut. Aliu e lëshon në mbrëmje dhe ende pa zbardhur dita pela godet me këmbë lesën e kasolles, ku në një kthinë me shelgje e pret mëzi i vogël pullali.

U ngrita dhe ashtu i zhveshur e qëllova pelën me një gur. Ndërsa ajo bëri tutje duke tundur jelet, vithet dhe gjinj të fryrë, qentë tundën

bishtin para meje dhe u ngjitën lart në stanin e dhive.

Mora një shkop në dorë dhe iu afrova hangarit. Kontrollova derën dhe shkova të shihja kubikët me vargjet e saposkuara. Kalova anash tyre duke vërshëlyer një motiv. Ktheva dhe një herë kryet gati kot, po padashur syri më mbeti në vrimë. U nisa shpejt dhe hapa derën e hangarit. Bashkë me mua u fut edhe drita e hënës.

Vrima, e hapur në gardh të hangarit, ishte e gjerë, por me vështirësi mund të nxinte një njeri. Poshtë vrimës, në shesh, kishte fier të shkoqur. Tri shufra ishin thyer. Ktheva sytë nga den-gjet, nisa t'i kontrolloja dhe, për çudi, ato ishin në rregull.

Kush e ka hapur këtë vrimë? Mos është hapur që ditën dhe unë nuk e kam vënë re? Të më kenë vjedhur? Mbase... Po cili?... — dhe nëpër mend më kaluan fytyrat e fshatarëve të mi. Po në duhan nuk ka asnjë shenjë! Apo mos është shkarisur ndonjë kafshë dhe e ka hapur vrimën me kaptell të samarit? Jo, jo, vrima s'duhet të jetë hapur nga kafsha, se tjetër shenjë lë ajo. Atëherë cili më vodhi, cili më ka inat? Mundet të kenë inat Minushin, mundet...

Ndërsa në krye më vinin lloj-lloj mendimesh, trupi m'u-mbulua me mornica dhe u rrëqetha. Fërkova pjesët e zbuluara të trupit, u ngjita dhe sakaq u gjenda mbi shtrat.

Kryet e mbajta jashtë derisa ra agu i mëngjesit.

Minushi erdhi herët, si zakonisht, më përshëndeti dhe u ul përmbri shtratit tim. Aty pleksi një cigare sa një puro dhe më bëri pyetjen e zakonshme:

— Ç'kemi?

— Asgjë, — thashë, megjithëse më erdhi keq

që nuk i tregova për ç'më kishte ngjarë. Le t'ia them më mirë kur ta gjej hajdutin, mendova aty për aty.

Ai mbaroi cigaren dhe u fut në kubikë, ndërsa unë mora dy trumba fieri dhe zura vrimën proqi-proqi, si i themi ne.

— Eja, — më thirri pas pak dhe unë shkova tek ai. — Që këtej deri tek kam ulur atë vargun do t'i heqësh e t'i bësh deng, po jo me shumë, se vonohen në tharje.

Që duhani të bëhet gati për manipulim, ne ia ndryshojmë vendin tri herë. E marrim nga kubiku me vargje, ku qëndron pak orë, dhe e vendosim në kubikun që kemi vetëm për dengje. Prej këtej, kur fleta shkoqet me prekje të lehtë, e varim në hangar.

Minushi më dha edhe disa porosi të tjera, më lexoi edhe punimin e tij që do të mbante në shkollë për duhanin dhe u nis për në qendër.

Fillova punën që në mëngjes, këtë gjithmonë e kam pasur qejf, po sot nuk më bënëni duart. Më shqetësonte ajo puna e vrimës. Ai që e kishte hapur atë, patjetër edhe do të kishte vjedhur. Duhet të numëroj dengjet, t'i di se sa janë. Kështu e kam më lehtë për të kuptuar nëse do të më vjedhin më.

Dhe me të thënë e me të bërë. Ishin pesëqind e njëzet dengje. Këtë numër duhej ta mbaja mend, po ashtu dhe ato që do të shtoheshin.

Shkova përsëri nën kubikë, i mbarova edhe ato pak vargje dhe u ula mbi gur. Po më kapiteshin sytë dhe ndieja marramendje. Ashtu me sy gjysmë të mbyllur dëgjova një zë. Ngrita kryet lart dhe shqova brigadierin. Ai vinte i paktë nga trupi dhe fytyrërrumbullakët.

U ngrita në këmbë dhe, sa e pashë që i nxinte fytyra, mendova se do të qe zënë me dikë. Ai

shikoi rrëmbimthi nga hangari, nga kubikët, dhe foli:

— Mbrëmë më tetë e gjysmë pse nuk ishe këtu?

Unë nuk fola, duke pritur të shpjegohej më tej.

— Ku vete, xhanëm? Je rojë, apo ç'je? Bredhin kafshët nëpër kubikë e ti se nga kullot? Jo, kështu nuk është mirë...

— Më tetë e gjysmë këtu kam qenë. Pyet po deshe Milen e Demon, se dëgjuam radiopostën.

— Domethënë ti ke qenë këtu? — tha ai duke shtrënguar tëmthat si të përtypte xham. Damari në ballin me djersë i ulej dhe i ngrihej me shpejtësi. — Në hangar s'ka dëme?

Unë bëra me krye.

— Do më shikojë dreqi! Do t'i numëroj fëlqinjët një e nga një. Balashi..., — mërmëriti brigadieri.

— Kush? — thashë.

— Le mo, ç'e do? Hajde mirupafshim. Kujdes aman, duhanin. Gjynah të na bëhet dëm, mezi e mbledhim, — tha ai dhe u largua.

Brigadieri ishte shpirt njeriu. Bashkë mbaruam shkollën e mesme, veçse ai e vazhdoi me korespondencë. Njerëzit në fshat e donin se fliste hapur e drejt.

Kapakët e syve po më rëndoheshin. Qëndrova disi duke përmendur fjalët e brigadierit. Ktheva trupin përmënjanas, u shtriva dhe më zuri gjumi.

Duhej të kisha fjetur shumë. Dielli që varur nga perëndimi. Bënte vapë. Trupi më që mbuluar me djersë dhe rrobat më qenë qullur. Kryet e kisha si të trullosur, ndërsa në gojë kisha një

athëtirë. Në fytyrë më ishin formuar vijëzime të kuqe nga karthjet e thata.

Shkova te një kubik. Aty plastmasën e kishin lënë pak të lirë dhe ajo, gjatë shirave, mbliidhte ujë. I hodha dy grushte ujë fytyrës dhe sikur erdha në vete. Pastaj shkova te shtrati dhe hapa trastën e bukës. Disa zogj të vegjël cicëronin.

Dikush po më thërriste me emër. Mbajta vesh. Emri im u përsërit dhe njoha xha Minon, rojën e vreshtit. Vreshti ndahej në dy parcela të mëdha: njëra mbjellë me shesh të zi dhe tjetra me hafëzali. U nisa për te xha Minoja.

Kur u afrova te shtrati i tij, pashë vorbujt e tymit të duhanit dhe në hundë më gudulisi era e këndshme e eshkës së ndezur.

— Lëri nazet, po hidhu lart!

Hipa te shtrati i tij, që ishte në mes të një lisi disavjeçar, nëpërmjet një shkalle.

— Do të hash një rrush? — pyeti xha Minoja.

— Jo.

— Po dhallë? Pi, se është paguri plot.

— Jo.

— More shejtan, çoç ke ti. M'i ke varur buzët sikur të ka ngrënë gomari bukën.

— Bukën e hëngra vetë, — thashë, — ja, ende kam thërrime mbi buzë, — dhe i fshiva ato me kurrizin e dorës.

— Ua? E po ngrëji ato vetulla, se s'i dua edhe ato petulla, — tha përsëri ai me ton serioz, që donte të thoshte: o çelu në fytyrë e bëjmë muhabet, o nisu...

Unë s'i ktheva përgjigje. Në gjoksin e tij të hapur përkundeshin qimet e bardha nga pufiza që nisi të frynte. Gjethet e thata të lisit anoeshin, përplaseshin me njëra-tjetrën duke kriju-

ar një zhurmë të lehtë ritmike fëëësh... fësh-fësh. fëëësh... fësh-fësh.

— E kuptova, je zënë me kanakaren, me Burbuqen, — tha xha Minoja duke nënqeshur. — I njoh unë femrat, bëjnë naze. Jo, do na shohë nëna, jo do na shohë babai. Ashtu ma bënte imja... Po jo, moj të keqen, të dhemb këtu apo këtu... dhe një ta karfosur... — dhe më shtrëngoi fort, si dikur nusen e tij.

— Lërmë, lërmë. Nuk jam zënë me Burbuqen. Më shikoi i habitur, duke picërruar sytë. Qenia e tij dukej sikur thoshte: po kjo pikë e zezë kështu?!

— More djalë i babait, ç'ke? — humbi durimin ai dhe më hodhi dorën mbi supe.

— Po ja, mbrëmë... — dhe i tregova fill e përpe ngjarjen si dhe fjalët e brigadierit.

— Shiko, shiko! Po për këtë mërzitësh ti! — ai shtrëngoi nofullat. — Do ta zëmë menjëherë. Ujku, po ra në kërmë, vjen çdo natë. Flije mendjen, djalë i babës, do ta përgjojmë e nuk na shpëton dot, — dhe më ra me shuplakë kurrizit.

U ndava me xha Miñon dhe, sa arrita në hangar, bëra një kontroll të imët, pastaj u futa në shtrat. Mbrëmja tani kishte rënë. Poshtë, në xhade, kalonin fshatarët që ktheheshin nga puna. Në vesh më vinin copa copa dialogësh nga bisedat e tyre.

Gjithçka e mbuloi errësira. Ndeza elektriku i dorës, formova disa zigzage në qiell dhe e fika. Tej hangarit flakërinte zjarri i arixhinjve. Pak nga pak flakët e zjarrit të tyre u shuan dhe unë mendova për hënën që ende s'kishte dalë. Ta kishte ënda të kundroje netët me hënë, e sidomos nga shtrati ku rrija unë. Nga pylli përbri, herë pas here, vinin shkulme flladësh të lehta, përzier me erën e luleve, të atyre luleve vjeshtake që në këtë muaj dukeshin shumë të bukura.



Mendja më shkoi te netët e para të rojës. Ndi-  
eja frikë. Nga ndonjë fërfërimë zogu në shku-  
rre apo nga ndonjë lëvizje fletësh që lëkundte  
era, fap-fap ia bënte zemra ime. Atëherë i  
flisja xha Minos. Gjithashtu këndoja edhe kën-  
gë ose vërshëlleja si për të trembur zhurmat. Po  
pas ca ditësh arrita të mësohesha dhe tani më vjen  
gudi si trembesha.

U ngrita nga shtrati. Mora një shufër tha-  
ne të trashë dhe e vendosa aty ku mbështetja  
kryet. «Ujku, po ra në kërmë, vjen çdo natë»,  
m'u kujtua. Po erdhi, do ta qëlloj! Po kë, va-  
llë?! Cili do të jetë?!

Kur isha i vogël, nëna më tregonte një pë-  
rrallë. Ajo fliste për një mollë që bënte bren-  
da ditës një kokërr të madhe. I zoti i mollës as-  
njëherë s'e provoi, pasi ia merrte dikush. Ai ki-  
shte edhe tre djem të rritur. Që të shkonte vetë  
ta ruante, s'shkonte dot, se qe i paralizuar. Dhe  
dërgoi në fillim djalin e madh. Qëndroi ai me  
dyfek në dorë deri në mesnatë dhe e zuri gjumi.  
Në të zbardhur të ditës vjedhësi e mori mollën.  
Kështu ndodhi edhe me djalin e mesëm. Më në  
fund shkoi djali i vogël. Ai, sa arriti te molla, ia  
këputi gjumit deri në mesnatë e pastaj u zgjua.  
Vjedhësi erdhi, si zakonisht, afër mëngjesit, dhe,  
në kohën që do të merrte mollën, djali e qëlloi...

Këtë përrallë nëna ma kishte treguar kushe-  
di sa herë. Mos më ndodhë edhe mua si u ndo-  
dhi dy djemve të mëdhenj? Jo, jo, gjithë natën do  
ta gdhij, edhe net të tjera do të rri pa gjumë,  
derisa ta kap. Për çdo gjë, ja ku e kam xha Mi-  
non, thosha me vete.

Malet që kisha përballë, filluan të vezullonin.  
Pritej të dilte hëna. Mora një copë eshke nën  
jastëk dhe, sa e ndeza, më cingërisi në hundë era  
e këndshme e saj.

Doli hëna. Rrezet e saj ranë butësisht përreth dhe dukej sikur praronte e ledhatonte çdo gjë me atë dorë pambuk!

Ndjeva uri. Mora një copë bukë me djathë dhe nisa të haja si i babëzitur. Qetësia mbretëronte. Njerëzit flinin. Herë-herë dëgjoheshin tinguj të shkëputur nga zogjtë që gugatnin në fole. Tani me siguri bredhin kafshët e pyllit, lëvrijnë sa andej-këtej për ushqim, Çdo natë te Shkëmbi i Sorkadhes çirret një dhëlpër. Bredh ajo dhëlpër, po bredh edhe Dakoja. Ai kushedi ku do të jetë. Atij do t'i vete sa të mbaroj këtej e do t'i lutem të më marrë me vete ndonjë natë.

Po afronte mëngjesi. Hëna ishte shtyrë tutje nga perëndimi. Drita ende s'dallohej mirë, ishte mugëtirë. Nisi të bënte ftohtë dhe mua më mbylleshin sytë.

Jo, nuk fle, se më gjen si ata djemtë e përrallës. Kishte një lidhje përrallë me paramëngjesin, pasi atëherë është më e vështirë mposhtja e gjumit.

Ndjeva një fërfëllitje. Ishin hapa të lehtë. Sado të lehtë, ata ndiheshin në këtë qetësi. Fërko-va sytë dhe dallova mirë një trup të zhvilluar me një kokë të vogël, rrethuar anash me një tis mjegulle. U bëra gati t'i flisja, po njeriu u drejtua nga hangari dhe ndali pikërisht te vrima. Filloi të hiqte fierin që e kisha vënë një ditë më parë e u fut brenda. Prej andej doli me torbën plot.

E njoha atë njeri dhe hëpërhë nuk më besohej. Si ta bënte këtë Resmiu? Unë me të nuk shkoja keq. Ai ishte një burrë dyzetvjeçar, i fuqishëm, por edhe i ditur. Qejfi i tij ishte të polemizonte. E kam pasion eristikën, thoshte. Ka qenë një traditë arti e sofistëve në Greqinë e Vjetër... Në mbledhje ai fliste më bukur nga të gjithë, po në fshat nuk ia vinin veshin. Edhe në

biseda fliste bukur, duke përdorur, herë citate latinisht, herë fjalë të urta angleze e prapëse-prapë njerëzit i thoshin: po lëri këto dëngla. Dikur ai kishte vazhduar edhe dy vjet shkollën e lartë. Vetëm dy vjet, se pastaj e kishin përjashtuar për çështje biografie...

Njeriu i civateve, me qetësinë më të madhe e fshehu torbën nën kupolën e një shkoze. Unë sakaq zbrita nga shtrati dhe qëndrova i fshehur. Përbrenda po vloja, sa s'mbaja dot, po për çudi mendimet më rridhnin qartë. Kur isha i vogël, nëna, sa herë që shante, thoshte: tutje Resmiu! Këtë e kisha dëgjuar edhe nga nëna të tjera, po sikur s'më vinte mirë. Ai punonte shumë, nuk dehej e nuk nxehej, megjithëse ndodhte që ndonjë e shante edhe rëndë. Para disa ditësh po u thoshte nja dy pleqve: bëhen dëme të mëdha. Ku bëhen? — i thashë disi i nxehur, se më dogji puna ime. Në vreshta, në pemë, tha gjakftohtë dhe më hodhi krahun prapa kurrizit...

Resmiu po vinte në drejtimin tim, kurse unë shtrëngova edhe më shufrën e thantë. Është e kotë ta qëlloj, mendova kur ai u afrua te shtrati. «Po xha Minua, ç'u bë? Ta këtë mundur gjumi i mëngjesit?»

Malet u zbardhën në majë. Qielli u kaltërua dhe ca re të vogla u shfaqën në të si tufa pambuku.

Resmiu zbuloi vendin, aty ku unë vendosja kryet, e mërmëriti: — S'ka qenë edhe sot, — dhe mori drejtqëndrim si të thoshte citate.

Ngrita shufrën lart («ky i paska thënë brigadierit»), shtrëngova tëmthat, i tërbuar nga mllefi («rojat nuk e bëjnë detyrën»), dhe u bëra gati ta qëlloja, po ndërkaq foli xha Minoja:

— Mos e zbulo djalin, more dhjakonar i dreqit, — dhe tundi torbën me duhan.

Unë mbylla sytë. Shufra ime goditi kokën e  
tij të vogël, që u var në qafën e shëndoshë.  
E qëllova? E qëlluam. Shufra godet pareshtur...  
Në duar gjak, gjak i zi...

Asgjë. Veç zëri i xha Minos:

— Te shtatë penxheret, në burg e ke vendin,  
— dhe u largua për në fshat. Pas ca, si hije, u  
përdrodh edhe Resmiu.

Unë lashë mënjanë shufrën dhe shikova vulan-  
gat e dritës mbi kryet e maleve të perëndimit.

## *Kushëriri Dali*

Frugën për në qytet e bëmë gati pa folur. Deri në qendër kishim shkuar disa herë me mësuesen kujdestare për ekskursion dhe më tepër për t'u qethur, një herë në pesëmbëdhjetë ditë. Sa hipëm në autobusin që shkonte në qytet, u stepëm në një qoshe dhe nuk folëm. Të dy mbanim pantallona të zeza dhe sandale me rripa. Të dy shkollim për herë të parë në mbrëmjen qendrore të pionierëve. Madje për herë të parë shkollim për të qëndruar në qytet, megjithëse fshati ynë ishte jo shumë larg prej tij. Unë isha në klasë të katërt, ndërsa Daliu, kushëriri im, në të tretën. Se si do të ishte mbrëmja qendrore e pionierëve, ne dinim shumë pak. Dinim vetëm që do të mblihdeshin pionierë në mbrëmje, do të këndonin e hidhnin valle e në fund do të na jepnin pako. Këto na i tha mësuesja kujdestare. Përveç kësaj, në të vetmin televizor të Skënderit, vitin që shkoi, pamë festimin e një mbrëmjeje të tillë në Tiranë.

Atje ishte edhe shoku Enver. Kjo na u kujtua disa herë mua dhe Daliut në prag të mbrëmjes. Jo vetëm kaq: «Sikur të vinte shoku Enver, ne të dy do të rendnim të parët, do t'i viheshim në krah dhe... ç'lumturi!...

Në hyrje të qytetit autobusi ndaloi, prej tij nisën të zbritnin njerëz.

— Zbresim, — tha Daliu. — Më duket se këtu na pret mësuesja.

Zbritëm. Qëndruam pa lëvizur. Njerëzit filluan të largoheshin dhe mësuesja s'po dukej.

— Do të rrimë këtu. Po të lëvizim, na shtypin makinat. Kështu më porositi mëma, — tha Daliu.

Qëndruam edhe pak, po mësuesja s'po dukej. Sakaq na u afruan disa moshatarë nga qyteti. Njëri prej tyre na tregoi me gisht e tha:

*Kokëqethur me gërshërë,  
bjeri topit, bëne vërë.*

Daliu u lëshua ta kapte, por ai ia mbathi me vrap. Pas tij vrapuan edhe të tjerët. Pas pak na iku zemërimi dhe bisedonim për gjithçka që shihnim. Bisedonim, pyesnim e përgjigjeshim vetë, po ndërkohë edhe ecnim. E harruam fare mbrëmjen. Dhe do të endeshim tërë ditën, në qoftë se nuk do të gjendeshim përballë mësueses. Ajo na gjeti në një klub të vogël duke ngrënë byrek. Ishte mbuluar nga djersët e megjithatë nuk na qortoi, na mori për dore dhe na çoi te shtëpia e saj.

Kishte kaluar dreka. Mësuesja na qerasi dhe na solli edhe një pjatë plot me portokalle. Nisëm të hanim. Daliu i fuste ato në gojë me gjithë lëvore. Pse ta fsheh: edhe unë doja t'i haja me

lëvore, por më vinte zor. Ndaj, me zë të ulët, i fola:

— Dali, lëre lëvoren në pjatë.

Ai më pa me inat: «mos i fut hundët në punët e mia», sikur donte të thoshte, po lëvoret zuri t'i linte në pjatë.

Pas pak mësuesja doli në korridor. Në këto çaste ne iu lëshuam portokalleve dhe i bëmë fit. Goja dhe buzët na përcëllonin nga lëngu i lëvoreve.

Shikuam njëri-tjetrin dhe qeshëm. Pastaj fshimë buzët, morëm nga një revistë dhe u bëmë të urtë.

Hyri mësuesja. Ne i mbanim kot revistat se, me bisht të syrit, shihnim nga ajo, që buzëqeshte lehtë.

Në mbrëmje mësueses i erdhi nëna dhe një motër oficere. Në tryezë u shtruan disa gjellë; nxorën edhe dhallë. Daliu herë pas here më shkelte syrin. Fytyra i shkëlqente. Edhe mua goja më qe lëngëzuar. Prandaj ne të dy, nga gëzimi e hutimi, atë që duhej ta hanim në fund e hëngrëm në fillim: i morëm sahanët me dhallë, përsheshëm bukë dhe nisëm të hanim. Këtë radhë, përveç mësueses, qeshi edhe motra e saj oficere. Ç'të mos qeshnin. Daliut hik... hëk, hik... hëk i filloi lemza.

Kur mbaruam sahanët, nëna e mësueses, me thinja të bardha mbi tëmtha, na tha me butësi:

— Hani edhe nga të tjerat, se dhallë ka në fshat.

Ne nuk folëm, po shikuam njëri-tjetrin në sy.

— Thuaje përsëri historinë e mbrëmjes, —  
më tha e shoqja e Daliut.

— Një herë tjetër.

— Të lutem, thuaje, që ta dëgjojë edhe im  
shoq, se ishte përjashta, — këmbënguli ajo.

E tregova përsëri historinë e mbrëmjes, po  
këtë radhë më shkurt. Gruaja e Daliut u mek  
së qeshuri, ndërsa Daliu u nxi në fytyrë e tha:

— Kjo nuk ka ndodhur! — dhe shikoi me  
zemërim nga e shoqja. Fjalët e tij më drodhën,  
po qysh nga kjo ditë nuk ia kujtova më.

Pas kësaj na ndodhi një incident (kështu e  
quajti Daliu, kështu do ta quaj edhe unë).

Si çdo vit, na kishte ardhur Daliu me leje.  
Atë ditë ishte e premtë dhe në shtëpi nuk na  
punonte radioja. Po daliu nuk rri dot pa radio.  
Bile, sa herë që vjen, merr me vete një tran-  
sistor që punon me bateri. Për fat të keq bateri  
nuk kishte, prandaj doli fshatit. Duke ecur në  
një kopsht pa Malon, një fshatarin tonë që po  
punonte. Daliu vuri dorën si strehë mbi ballë  
e i tha:

— Ke gjë bateri?

Maloja picërroi sytë. Pastaj e pa drejt.

— Çfarë?

— Bateri.

— Përse?

— Se u shurdhova.

— Radio jemi ne, — tha Maloja, — radio  
është fshati, punët e mira të fshatit.

— Çfarë thua? — ia ktheu Daliu dhe i ngriu  
kombi në grykë.

Maloja e shikonte drejt në bebëzat e syve,  
sikur t'i lutej që t'i kuptonte shpjegimet e tij.

— Çfarë thua?



— Aaa! Dëgjoje edhe radion. Po them se, meqë lodhe gjunjët e u ngjite gjer në fshat, hajde e dëgjona goja-gojë. Se, s'të ikën qyteti, po ndenje me ne. Hë, bir!

— S'kuptoj.

— As unë s'ndiej ç'blegërin! — tha Maloja dhe i mëshoi belit thellë.

Daliu iku. Kombi i grykës nisi t'i lëvizte me nxitim. «Njerëz të rëndomtë», mërmëriti sikur të ikte nga një e ligë që mund t'i ngjitej.

Daliu erdhi në shtëpi dhe më tregoi se si i kishte ndodhur. Këtë herë e ndjeva veten ngushtë dhe s'munda t'i thosha asnjë fjalë. Po, po! Edhe më parë e kam ndier veten ngushtë. Fshati ynë është shumë afër rrugës automobilistike. Po Daliu edhe këtë copë rrugë donte ta bënte me makinë. E shoqja ndryshonte. Ajo dilte edhe në fshat e takohej me njerëz, vente edhe bostaneve me gratë dhe, sa rrinte te ne, fytyra i qeshte. Daliu e kishte harruar fëmijërinë. Më dukej se atë s'e ngrohnin as cicërimat e zogjve, as burimet, as puna e fshatarëve... më dukej se asgjë s'e ngrohte. Bile edhe kujtimet e vegjëlisë. Unë vetëm diçka i kisha përmendur dhe ai që nxirë në fytyrë. Po sikur t'i thosha se më ka mbajtur disa herë kaliqafë, duke bredhur kodrave, ai me siguri nuk do më shkelte më në shtëpi.

Kthehesha nga puna, e gjeja të mbyllur në dhomë duke dëgjuar radion dhe nëpër mend më vinin fjalët e fshatarëve: «Daliu nuk del dot jashtë se vuan nga majasëlli».

Ndryshonte shumë kushoja im nga fshatarët e tjerë që banonin në qytete. Ata, sa vinin, sikur e gjallëronin fshatin. Ndonjë fliste për luftën, ndonjë për ngjarjet e jashtme, ndonjë tregonte si që çoban e pastaj ishte veshur polic...

Daliu ndenji dhe ca ditë, mbaroi lejen dhe u

nis për Tiranë. Para se të ikte, m'u lut t'ia gjeja shtëpinë në qytet.

Një ditë dhjetori, dyzet veta të dalluar nga kooperativa jonë do të shkonin në Tiranë për të parë Muzeun Kombëtar Historik. Ndër të dyzetët isha edhe unë.

Kur u nisëm, bënte ftohtë. Po ne e ndienim veten mirë. Na gëzonte lulëzimi i qyteteve që shihnim nga autobusi.

Arritëm në Tiranë dhe u kënaqëm. Kryeqyteti po bëhet gjithnjë më i bukur. Na u ngop syri dhe na u mbush zemra. Pale kur hymë në Muze. U gëzuam. Fshatari, shpesh, gëzimin e ka ndryshe: jo vetëm i qesh fytyra e i shkëlqejnë sytë, po sikur i qeshin edhe rrobat. Do ti që s'na pushonte goja nga hareja!

Kështu, i gëzuar në shpirt, u nisa për te kushoja im Daliu. Edhe ca shokë të mi vajtën nëpër miq e kushërinj. Ishin njerëz që prisnin e gëzoheshin kur u venin nga fshati. Edhe mua më buisën mendime të mira për Daliun. Sa do të gëzohet! — thosha me vete. Sa do të gëzojë grujaja, djali. Do t'u duket çudi që papritur vij që nga larg dhe, fup, në shtëpinë e tyre. Sikur u vete gjithë fshati.

Isha afruar përpara pallatit. Ngjita shkallët dhe trokita në derë. Prita pakëz me ndjenja të mira.

U hap dera dhe para meje u shfaq Daliu, i lartë siç ishte, i mbështjellë me një xhup me push. Sakaq iu hodha në qafë dhe e përqafova fort.

— Erdha në Tiranë! — i thashë me gaz. — Kemi ardhur plot. Erdhëm si fshat. U nisëm që

me të rënë të sabahut e sosëm në mug. Ndalo në një vend e shiko, ndalo në tjetrin e hap sytë. S'mbaheshim fare: këndo gjithë rrugës dhe tani jemi ngjirur...

Daliu nuk foli. Gjysma e fytyrës, që nuk ia zinte jaka e gëzofit, i kishte ndryshuar ngjyrë. Më erdhi çudi, në vend që të më fuste brenda, ai qëndronte si i ngrirë para meje. S'm'u durua, por i fola me zë të lartë:

— A je ti Daliu që banon në Tiranë, që je kushëriri im dhe e bën lejen.. — këtu e preva fjalën.

— Unë jam, po sot lyejmë shtëpinë, — foli ai me zë të mekur dhe më kapi duart si i për-  
vuajtur. Ishte hera e parë që e dëgjoja atë zë.

— Lyeni shtëpinë?!

Ai lëvizi pak kryet.

— E po thuaje, të shkretën. Ne jemi te hotel «Arbëria». Merr gruan dhe djalin e eja të takohemi. Eja, në do, edhe në mes të natës, se ne në dritare do na gjesh. Eja, se të kam sjellë radio-fshatin tënd që ta dëgjosh. Është i gëzuar fshati. Gëzojnë...

Zbrita shkallët. Pas pak e harrova Daliun. Në vesh më erdhën tinguj kënge. Do t'ia kenë marrë ata të fshatit. Ç'them unë! Këtej hoteli është larg. Këndojnë të tjerë. Ka dasmë.

Vazhdoja të ecja. Pas pak takova një të njohurin tim dhe shëtitëm bashkë. «Tirana e bukur», mërmërita. Njerëz të bukur të vendit tim! Lëviznin njerëzit e zhurmonte qyteti dhe mua më dukej se të gjitha rrugët hapeshin para meje.

## *Shqetësimet e nënës*

Nëna ime ishte në hall. Djali i saj, i madhi, vëllai im, i kishte mbushur të tridhjetat dhe ende s'ishte martuar. Prandaj ajo, kudo që shkonte, për të do të mendonte. Thoshte se e shikonte shpesh në ëndrra. Shikonte në ëndërr djalin e saj me nuse, me atë nuse që i mërmëriste: «Nënë, u lodhe, pusho pak.» Dhe ajo ia kthente: «Jo, nuk lodhem u!» Atëherë nëna, e kënaqur, e çli-ruar në shpirt, do t'ia lante ndërresat. Po ç'e do, vëllai im ende s'po rregullohej. Ai nuk sillte një nuse. Nuk gjenim nuse. Dhe kjo e mërziste, e shqetësonte nënën. Ndërsa ai kthehej në shtëpi dhe pasi dëgjonte në heshtje lumin e fjalëve të nënës, ulte pëllëmbën e butë mbi shpinën e saj dhe belbëzonte: «Mos u mërzit, nënoke!» Po nëna nuk qetësohej. Ajo zgjohej shpesh natën dhe psherëtinte. Psherëtinte...

Qëllonte që të ishte në oborr dhe të shihte tek vinte im vëlla. Ai përsëri vinte fillikat. Fi-

llikat! Kështu, mërzitej nëna. E mërziste kujtimi i hidhur i dy djemve të dajës së saj, që u plakën pa u martuar.

«S'ka lezet shtëpia pa të qara fëmijësh», pëshpëriste ajo nëpër oborr.

Babai im ishte plak, dhe nëna përgjerohej që edhe ai t'i gëzonte fëmijët e fëmijës. Ai sikur po tretej nga shkaku i djalit. Pátjetër nga ky shkak, pëshpëriste ajo. Mbrëmjeve kuvendonte shpesh me të shoqin, por ai s'jepej. S'jepej, po në shpirt ishte i vrrarë.

Ja, këtë e kishte peng të madh në zemër nëna ime. Kjo e shqetësonte. E shqetësonin gjithashtu edhe fjalët e botës. Si i sëmbonte asaj kur i thoshin: «Kur do t'ia bëjmë bam te djali?» «Avash, avash», pëshpëriste nëna.

— S'ka avash-avash, — thirri nëna papritur një të shtunë herët. Ishte e shtuna e 15 gushtit 1979, kur hyri në dhomën time dhe më hoqi velenxën.

— Ngrihu, — më tha, — ngrihu!

E shikova i shqetësuar.

— Eja, — thirri përsëri ajo me ngut.

Pas ca u vësha dhe u nisëm. Arritëm në qendër dhe prisnim të vinte «fizarmonika».

— Ku do vemi? — e pyeta.

— Në Valetë, — tha ajo. — E di ti udhën për në Valetë?

— Prapë për nuse? Nuk dua të vij, merr po deshe motrën.

— Të ardhka rëndë?

— Më vjen, kur s'është i zoti...

— Aq! — nëna u nxi në fytyrë. — I ke buzët me qumësht e s'të ka ardhur radha të japësh mend.

Toni i saj sikur më urdhëronte: «Mos fol më!» Mbi një degë rrapu cicërinte papushuar një zog.

Erdhi «fizarmonika». Hipëm. Ajo ishte mbushur plot e përplot. Kështu ndodhte zakonisht të shtunave. Në krah me ne ishte një plakë që mbante lart një fëmijë e që i thoshte me përkëdheli: «U shtype, o pëllumb i gjyshes, u shtype, që vdekça u për ti!» Nëna shikoi nga unë, më shtrëngoi fort dorën dhe iu mbushën sytë me lot.

Zbritëm nga «fizarmonika» përpara një kafejeje. Andej niste qyteti. Në krah të kafenesë ishte agjencia e automjeteve. Në sheshin përpara saj kishte njerëz. Kishte edhe disa makina. Morëm djathtas. Nën ne vraponte lumi. Nëna qëndroi mbi parmakun e urës dhe vështronte për ndonjë makinë. Ndërsa unë ula kokën poshtë dhe ndiqja me sy një copë dru që ulej dhe ngrihej mbi valët e lumit. Anash zgjatej asfalti. Në të dyja anët e tij, të vënë në radhë, rreshtoheshin disa plepa të lartë.

Kisha uri. Nëna kishte marrë me vete bukë me djathë, po ç'e do se djathi na ra në shesh kur po hipnim në autobus.

I kërkova nënës lekë për një byrek. Ajo futi dorën në çorapet e zeza dhe më zgjati një lek. Shkova e bleva dhe, sa erdha aty ku rrinte ajo, kapërdiva kafshatën e fundit.

— Hë, se u plakëm, ç'presim më! — tha nëna.

Unë nuk fola, po vazhdova rrugën i pari. Ajo më ndoqi pas dhe dëgjova trak-trukun e këpucëve të saj, që i kishte nxjerrë nga fundi i sëndukut e që u kishte futur brenda copa kartoni se i rrinin të mëdha. Pas pak më arriti dhe ecnim në një hap. Kur u ndodhëm përballë një kryqëzimi, më pyeti:

— Këtej do mbajmë? — dhe bëri me dorë majtas.

— Këtej.

— Qenka asfalt?! A, ishalla na bëhet, se do na vijë rehat, — pëshpëriti ajo.

— Kush? — thashë, ngaqë mendoja për tjetër gjë.

— E pastaj...! Të ka faj?!... Ajo mo, ajo e kushura, ne përse vemi në Valetë? — tha e nxehur. Tunda kokën disi i penduar.

Vazhdonim të ecnim rrugës që të shpinte në Valetë. U dëgjua ulërima e një makine.

— Ta ndalojmë, — tha nëna kur makina u afërua, — mbase vete në Valetë.

Unë pohova me kokë. Ajo nxori dorën para dhe mënga e palltos iu var poshtë. Llëra e dorës së përveshur deri në bërryl dukej e hollë, me damarë të tharë e lëkurë të tejdukshme. Edhe në qafën e mpakur lëkura vinte e rreshkur dhe e verdhur. Ndjeva keqardhje. Gjithçka te nëna ime, trupi, llërët, këmbët, qafa, m'u dukën të imta. Ajo kishte kohë, mbase qysh atëherë kur i tha vëllait «gjej nuse», që nuk zhvishej më në sytë tanë. Veç unë e kam parë një herë dhe trupi mu' rrëqeth, u drodha e ndjeva keqardhje njësoj si sot. Në atë trup të dobët, përveç këmishës fanellate, që arinte mbi gjunjë, ajo vishte edhe dy jelekë të leshtë, të trashë, të cilët ne s'ia dinim. E fshihte hollësinë e saj. Vëllai im nuk e ka ditur këtë, përndryshe do ta kishte sjellë nusen. Me nuse të djalit në shtëpi ajo «do të bëhej me fletë». «S'dua të vdes pa i martuar të gjithë evlatët», thoshte. «S'dua të më gjejë si Dilikon e Kipes, që polli në pleqëri një karvan fëmijë e nuk i martoi dot. Nuk e treti dheu, të shkretën, e mbajti darameti i tyre...»

Makina ndaloi dhe hipëm lart. Me ne hipi edhe një burrë i ri. Ai i kishte duart të buta, fytyrën të lëmuar dhe flokët kaçurrelë. Dukej si mësues.

Ai u ul në një-kënd të ngritur si stol në krye të karrocerisë. Çantën e mbante nën sqetull.

Rrugën e bëmë gati pa folur, vetëm se shkëmbeva cigaren me burrin flokëkaçurrel që më dukej si mësues. Shikimi i nënës nuk më ndahej.

Zbritëm. Përpara shtrihej fshati i ndërtuar me sistem. Shtëpitë ishin të gjitha njëkatëshe. Nga ana e poshtme e xhadesë, që zgjatej përmes fshatit, ndodhej një kanal me pak ujë. Më tutje, në të djathtë, rridhte me ndërprerje çezma. Mali këtej dukej shumë larg. Përbri kishte fusha të mëdha. Përpara nesh ishte një shesh i madh që gumëzhinte nga njerëzit. Aty duhej të ishte qendra e fshatit.

Qëndruam një çast. Në këtë fshat ne kishim një të njohur, që quhej Axhem. Dy mbesat e tij ishin martuar në fshatin tonë. Njërin prej tyre e kishim komshie dhe Axhemi, kur vinte te mbesa, vinte edhe te ne. Pra ishim si miq.

Nëna më tha se do të venim njëherë në shtëpinë e Axhemit. Që andej në shtëpinë tjetër ku do të kërkonim nuse për vëllanë.

Nëna hodhi vështrimin nga fshati, ktheu kryet nga unë e tha:

— E kam të larë surratin

— E ke borë, feks e llamburin. Pse s'u lave kur u ngritëm nga gjumi?

— Aman dhe ti, ç'ia zien, po ku na priste puna. — Lagu cepin e shamisë me pështymë e ia kaloi fytyrës.

— Hajde, — tha pas pak, — hajde të pyesim ndonjë për shtëpinë e Axhemit.

— Pyet ti, se mua më vjen zor, — thashë.

Hodhi përsëri sytë përçark, i ra palltos me dorë dhe, kur pa një burrë aty afër, e pyeti:

— Shoko, ku e ka shtëpinë Axhemi?

— Shtëpia e Axhemit...? Ja, ai është djali i



tij, — dhe bëri me dorë. — O, Izet! — thirri fshatari.

Pasi u takuam me Izetin, morëm udhën drejt shtëpisë. Nëna me Izetin ecnin para. Ai dukej qose nga fytyra. Ajo e pyeti atë nëse e kishte mbaruar ushtrinë dhe ai iu përgjigj me një «po» të rëndë.

— Kthehu këtu, — tha djali, kur nëna kishte ecur pak më përpara.

— Kjo është shtëpia juaj, ë!? Të mirë e të argjendte e keni. Ju është tërbuar fare dhria, — tha ajo për hardhinë, kur shkeli në oborr.

Përpara shtëpisë, në një vend të ngritur si potom, rrinte një grua e bëshme. Kishte fytyrë të gjerë. Mbi prehrin e saj kishte mbështetur kryet një djalë pesëmbëdhjetë-gjashtëmbëdhjetëvjeçar.

Gishtat e gruas ishin zhytur në flokët e djalit. Në anën e majtë të oborrit ishin mbledhur shuk disa rroba. Me sa dukej, po pastronin dhomat.

Oborri, i mbuluar me hardhi, ishte në hije. Bënte fresk. Nga boshllëqet e fletëve të hardhisë kalonin fjolla drite që thyheshin mbi pllakat në shesh. Vilet e rrushit me erë përshkoheshin nga drita dhe merrnin ngjyrë të zezë të çelur. Në dritare vareshin lule dredhëza, pjesërisht vendosur në helmeta.

Gruaja, sa na ndjeu, i ngriti kryet djalit. Fytyra e saj u bë me turp që i gjetëm ashtu. U ngrit në këmbë. U ngrit dhe djali si i shushatur.

— Si je? — pyeti nëna. — Kallaballëku, burrin si e ke?

— Çka, mirë, të marrin dorën, — tha gruaja ende e skuqur dhe e përqafoi. Mua më puthi në sy.

Te dera u duk Axhemi me sy të fryrë. Buzët

i kishte të trasha dhe fytyrën të shëndetshme, por të varur.

U takuam. Nëna e kuptoi që ata po pastronin shtëpinë, prandaj hapi muhabet që jashtë:

— Ti je kunata e Frosos?

— Cilës Froso?! — pyeti gruaja, e habitur.

— Gruan e Bexhetit, moj, e ke kunatë, të vëllait tënd?...

— Unë s'kam vëlla fare, — ia la fjalën në mes ajo.

Mos i shëmbëllen me ndonjë, mendova. Nëna e pa që këtej nuk doli gjë, prandaj, pa e humbur toruan, u hodh në degë tjetër.

— Ishe në fshatin tonë kur vdiq merhumi Baki? — Gruaja pohoi me kokë. Nëna vazhdoi:

— Më ke bërë përshtypje të madhe, si qaje me ato ligje...

Ajo fliste shpejt, por i zgjidhte fjalët. Gruas së Axhemit iu bë qejfi. Më vinte për të qeshur me nënën, i lidhte ato fjalë e ua bëri mendjen dhallë. Fliste e më shikonte edhe mua. Në raste të tilla, kur ishim vetëm, shpesh më thoshte: «Mua më digjet mjekra, ti thua dale të ndez cigaren», domethënë mos qesh kur jam në hall.

— Kjo është vajza ime, e dyta, — na njohu gruaja me vajzën. Ishte një vajzë me trup mesatar, me flokë krela-krela mbi supe. Nëna, duke u takuar, tha:

— Të madhen e ke martuar në Mesaq. Më kanë thënë që ka dalë e mirë. Se vajza lezetin te burri e ka. Dhe ajo vitore fare është. Po ka dhe atë çikë djalë!

Vajza me flokë krela-krela doli jashtë.

Muhabeti vazhdoi. Nëna po i bënte për vete. Në dhomë ndihej vetëm zëri i saj.

Vajza na solli llokume e kafe.

— Shtëpitë i keni të mira, — tha nëna, pasi

rrufiti kafen. — Mobla paski plot, të rroni e t'i gëzoni dhe me një short të mirë për vajzën, — dhe rrufiti kafen.

— Faleminderit, të të rrojnë fëmija, — tha Axhemi.

— Këtë, Izetin, s'e keni martuar?

— Jo, moj, jo, po ja, avash-avash, — tha gruaja. Nxori një rënkim të shuar dhe mblodhi buxët. Izeti rrinte i ngrehosur.

— Nga do ngjash, djalo? — pyeti nëna.

— Nga babai, pse, nga mamaja?! — tha dhe vendosi cigaren midis buzëve.

— Jo, se ky timi, — dhe me dorë më tregoi mua, — më thotë se do ngjajë nga të dy.

— Ja, gërnjar si i ati. — tha gruaja dhe shpërvoli buzët.

— Po kujt t'i ngjaj, në arë hedh misër e misër del, — e mori fjalën Izeti dhe shikoi nga Axhemi, të cilit iu bë qejfi.

Izeti ndezi cigaren. Era e fijos së shkrepëses na gudulisi hundët. Ra heshtja. Rrezja e dritës, nga dritarja, binte mbi një tablo. Në të dukej një karrige me mbështetëse të kthyer. Mbi karrige qëndronte hijshëm një vajzë me sy blu. Përpara gjoksit mbante fizarmonikën dhe shikimin e treste mbi diellin që po lindte mbi det. Flokët e vajzës gjenin prehje në të dyja anët e fizarmonikës, ndërsa duart mbi tastiera e base.

— Si i kam mbesat? — pyeti Axhemi.

— Shumë mirë. E vogla bleu makinë qepëse. Vajta njëdizaj për ta uruar. Dhe ajo tjetra mirë është. Mirë janë vetë, mirë janë burrat e mirë fëmijët, — u përgjigj nëna.

— E po çka, të jenë mirë, — tha Axhemi, — se goja dëfton bojën.

Nisi të frynte puhizë. Perdet e dritareve lëkundeshin lehtë.

— Ju nuk më pyetët si e kam hallin, — filloi nëna. — Dëgjoni, se për të mirë kam ardhur, për miqësi.

Të gjithë në dhomë prisnin se ku do të dilte nëna. Nga dera hyri vajza, duke hequr disa papastërti mbi bufenë rrëzë murit.

— Kam ardhur të kërkoj vajzën e Guxho Halimit për djalin. Më kanë thënë që është vajzë e thjeshtë. Ju e dini, një motrën e saj e kemi marrë në fshat dhe ka goditur e mirë, në punë e në shtëpi, e urtë dhe e padëgjuar. Djalin unë e kam div, sa muri i gjatë. Ka ngjarë nga dajkot. Fshati e mban në gojë. Na, kaq (dhe hap duart) janë fletëlavderimet. Unë i kam të tërë të mirë, dhe të tjerët, mësojnë bota nga ta. Të viç në fshat tonë, «si djemtë e Halitit» thonë. Të katër vetullzinj i kam. Tani, ne do të vemi njëherë, në na pranofshin për miq, mirë se mirë, në s'na pranofshin, prapë s'ka gjë. Qërova shtigjet dhe erdha.

— Ju bëtë mirë që keni vendosur të kërkonit atë, se për kokë të fëmijës, si vajzë s'ke ç'i thua! — tha Axhemi.

— Djali ku punon? — pyeti gruaja e Axhemit.

— Është i veshur, në ushtri, vazhdon ekonomikun, të lartën, me korrespondencë, — tha nëna aty për aty.

— E, mirë, ç't'ju themi ne, ju vaftë mbarë! — tha Axhemi, duke buzëqeshur. Gruaja e tij, që e mori sikur ai na tha që «ikni tani, mbaroni punën», u hodh:

— Dale, të venë kur të duan, — dhe vështroi e zemëruar atë.

— Mirë, të rrinë. Sikur u them unë ikni! Po është mirë, se i gjejnë të dy, burrë e grua, tani në shtëpi, — tha Axhemi.

U ngritëm. Lamë fytyrën, fshimë këpucët dhe u nisëm.

— Mbase na vete mbarë, — tha nëna me pshe-rëtimë.

Unë s'foli. Arritëm në oborrin e tyre dhe tro-kitëm në derë. Atë e hapi një vajzë e gjatë dhe e hollë. Ajo nuk u përshëndet fare me ne, por u fut në dhomën djathtas.

— Urdhëroni! — tha e zonja e shtëpisë.

Me sa dukej, ajo do të ishte nëna e vajzës që ne do ta kërkonim për nuse. Ishte një grua që në moshë s'i vije dot kufi, midis gruas së vje-tër dhe plakës, me dy shami të zeza në kokë, që i rraste deri mbi sy. Ajo puliste herë pas here sytë.

Nëna e përqafoi. Pastaj u ulëm mbi divan. Nëna e vajzës na solli llokume e karamele.

Nisën pyetjet e zakonshme, këto si hyrje. Pas pak erdhi dhe Guxhoja. Ishte i mbajtur mirë. Në anën e djathtë të veshit, në mes, i varej një kokërr mishi e kuqe.

Biseda vazhdonte shtruar. Gruaja solli mulli-rin dhe një çanak me kokrra kafeje. E mbushi atë dhe filloi të bluante.

Unë u mërzita. Ndihesha ngushtë.

— Ma jep ta bluaj unë, — thashë dhe zgjata duart për ta marrë. Pas një kundërshtimi të leh-të, «nuk vihet miku në punë», ma dha.

Lëvizja dorezën vazhdimisht, me zhurmën e saj përziheshin fjalët, ndërsa unë isha zhytur në mendime të tjera dhe dëgjoja fraza të shkëputu-ra. Lëvizja dorën dhe bluaja. Më dukej sikur nuk bluaja vetëm kafe, por edhe diçka tjetër... Kjo më dukej si diçka e zezë, elastike, që u shpë-fonte dhëmbëve të mullirit. Për një çast doreza u lehtësua. Më në fund u blua... Jo, ka ende ça-naku, çanaku prej alumini...

Mbusha përsëri mullirin. Qindra mendime më vinin vërdallë nëpër mendje.

Këtë radhë e boshatisa shpejt. Përsëri mendimi që më godiste si çekan në tru kur u nisëm: A di gjë vëllai që ne duam ta martojmë në këtë mënyrë? Jo, s'di... S'duhet të dijë. U dobësua nëna se do nuse për djalin, për vëllanë tim. Jo, ai s'duhet ta pranojë, qoftë e rënë nga qielli kjo nuse. Për të gjitha këto fajtor është vëllai, fajtor jam unë. Ai duhet të martohet vetë. Të jetë ç'të jetë, mjafton që e merr vetë. Vazhdoja të lëvizja dorezën bosh dhe do të isha zgjatur kështu sikur të mos më kishte folur gruaja e Guxhos. Kafja kishte mbaruar. Ia zgjata mullirin.

— Kështu ta lëmë, — tha Guxhoja. — Lajmëroni djalin, ç'është sot, e shtunë, të shtunën tjetër eni të dy me djalin, të shikojnë njëri-tjetrin. Ne e japim me të dyja duart. Ja, të njohëm ty, e njohëm dhe atë.

Ra qetësi. Nëna dukej e gëzuar. Këtë e kuptoja vetëm unë.

— Bëna atë kafen, se u blojt, — tha Guxhoja duke qeshur me vështrim nga unë. S'lëviza as qepallat. Kafja u blua, mendova, por ajo diçka e zezë, e mugët, ende.

Filxhanin që ma vunë përpara, nuk e preka fare, me pretext «se nuk e pija». Do të isha bërë nervoz, po ta vazhdonin përsëri bisedën për martesën, por ata e prenë. Si dukej, u mbaruan llafet...

Ora po shkante dymbëdhjetë dhe më dukej jo sikur kishin kaluar katër orë, por katër vjet... katër...

Nëna u ngrit. U ngrita dhe unë. U përshëndetëm dhe u nisëm.

— Kalojmë arave, se makina na tallandis, — tha nëna.

— Mirë.

Ajo ishte e gëzuar. Morëm rrugën lart arave që verdhënin nga luledielli. Këto duhej të ishin për foragjere, se vjeljes së lulediellit kokërr i kishte kaluar koha.

Nëna nisi përsëri bisedën për fejesën e vëllait, por unë ia preva në mes.

— Më dhemb koka, — i thashë. Dhe me të vërtetë më dhimbte.

Përpara nesh doli një kanal i madh, i mbushur me ujë të ndenjtur. Brenda tij kishin mbirë lloj-lloj bimësh. Nga të dyja anët e kanalit kishte bazament çimentoje. Kalova matanë dhe, kur pashë që mund të kalohej, hapa këmbët në të dyja anët e kanalit.

— Hajde, — i thashë nënës, — hajde të të marr në duar!

Ajo në fillim ngurroi.

— Hajde, moj, por, po re brenda, prapë do të ngrihem.

— S'e bëri të gjatë dhe u lëshua në duart e mia. Ajo peshonte pak, shumë pak i peshonin kokat, dy jelekët e leshtë dhe «sukullat», siç thoshte vetë për rrobat e tjera. Por ndihej e lumtur, e gëzuar dhe tani mund të të fliste pa reshtur e pa u lodhur.

Duke menduar me dhembje për nënën, më humbi ekuilibri. Këmbët i kisha hapur jashtë mase dhe shkava në ujë. Pa e humbur mendjen, nënën e kalova në anën tjetër. Ajo s'u lag fare, ndërsa unë vetë deri në gju. Dola matanë, shkunda këpucët dhe shfryva:

— Duam nuse!? — thashë. — Dhe si fejohet vajza pa, çak-fap!

Nëna nuk fliste, po shikonte në këmbën e majtë vendin ku mbante lekët. Unë turfulloja. Pas dy orësh arritëm në fshat.

Ishte e premte. Nëna ishte shtrirë. Kishte qenë për të lajmëruar vëllanë. Sa isha kthyer nga puna. Po binte mbrëmja. Kishte nisur të frynte një erë e lehtë.

Të gjithë ranë për të fjetur. Kalova matanë nga dhoma tjetër dhe mora një libër. U shtriva në shtrat.

Fërkova sytë gati kot.

Përsëri mulliri: «trrak-trruk, trrak-trruk».

Ndeza një cigare dhe dola në kopsht. Hëna e pushtetshme shkëlqente plot madhësi. Jashtë dukej si ditë.

Dëgjova lëvizje fletësh dhe sakaq në gjoks m'u hodh qeni ynë, Bedulla. E ula lehtas në tokë dhe ajo iku tutje duke angullitur.

Hyra brenda dhe hapa radion. Emisionet kishin mbaruar. Duhej të ishte vonë. U shtriva në shtrat dhe zemra nuk më bënte për asgjë. Nisën të më sulmonin mendime të turbullta.

As vetë nuk e kuptova si më zuri gjumi.

Më dukej sikur ecja. Ecja dhe pas më ndiqte «trrak-trruku» i mullirit. Lëvizja dorezën me shpejtësi. Vetëm unë me mulli në dorë... Bluaja pa pushim: «trrak-trruk, trrak-trruk, trrak-trruk». Më mpiheshin muskujt, më thyheshin gjunjët, por unë ngrihesha dhe përsëri bluaja... Tani më dukej se nuk isha vetëm, po të gjithë njerëzit. Të gjithë kishin dalë rrugëve, shesheve, me mulli në dorë, duke bluar...

Hapa sytë. Dera trokiste me të madhe. U ngri ta dhe shpejtova për ta hapur.

E hapa dhe menjëherë njoha siluetën e vëllait. Ai më përqafoi. Matanë, në dhomën tjetër, nëna, në gjumë, psherëtiu.

Vëllai, duke zbathur këpucët, më tha:

— Do të të gëzoj?

E shikova drejt në sy. Ai futi dorën në xhepin



e brendshëm të xhaketës ushtarake dhe nxori një fotografi. E pashë fotografinë. Ishte një vajzë me fytyrë të rrumbullakët e me trup të hijshëm, dalë përpara dy saksive me lule. Ja, aty ishin tri saksitë me lule dhe më e mira, e mesit. Ngrita këmbën dhe pashë përsëri vëllanë në sy. Ai vazhdoi:

— Është fshatare. Vjet mbaroi shkollën bujqësore. Punon brigadiere... Mirë?

Nuk e lashë të mbaronte, por iu hodha në qafë dhe e përqafova.

— Do vish pasnesër, ta shikosh! — tha vëllai.

— Vemi që sonte, natën, në këmbë, — thashë dhe qeshëm të dy.

Dera ishte ende e hapur. Hëna vezullonte dhe nata dukej më e bukur. Dola dhe hapa derën e dhomës ku flinin nëna me babanë e thirra:

— Nënë, shuaji psherëtimat!